

Intervistë me shkrimtaren dhe përkthyesen e njohur

MIRA MEKSI

Jam shërbestare e
gjuhës shqipe, të cilën
e konsideroj të shenjtë

E vërteta është se nuk e kam ndarë dot përkthimin letrar si krijim, nga krijimi im letrar. Ka nisur shumë herët si një proces i pandarë që, mendoj, zanafillën e ka pasur te leximi im i pandalshëm që “përpinte” gjithçka që më dilte përpara, pa asnjë lloj kriteri, që kur lexova vetë në moshën pesëvjeçare “Xinxifllon” e Kutelit, dhe dëshira po aq e madhe për t’i ndarë me të tjerët mrekullitë e leximit.



Portreti nga Ina Lajthia

Romani “Dëmtuar gjatë rrugës”
i BESNIK MUSTAJ

Të rrëfesh nga sytë
e një foshnjeje

nga Namir Lapardhaja

f. 5

NDAHEN
ÇMIMET
KULT 2019

f. 5

Skicat nga Bujar Kapllani




DIELLI, DHE NJË POEMË QË SPEKULLON ME TË

(Shënime kritike mbi poezinë e Fasli Halitit nga dhjetë
gjimnazistë – gazeta “Shkëndija” 25 janar 1973)

Nuk na e priste mendja se Fasli Haliti do të shkruante një poemë të tillë si “Dielli dhe rrëkerat”. Ajo është frut i një çoroditje politike e ideologjike dhe na jep një pasqyrë në themel të shtrembër të realitetit tonë, të natyrës së pushtetit popullor dhe të marrëdhënieve të partisë me popullin.

SALVADOR DALÍ

*A mos jam gjení
vallë?*



Në moshën gjashtë vjeç doja të bëhesha kuzhinier. Në moshën shtatë vjeç, Napoleon. Edhe më vonë dëshirat e mia shtoheshin jo më pak sesa synimi për t’u ngjitur sa më lart drejt madhësisë.



ATJON ZHITI

*Një mozaik me ngjyra dhe
fjalë: ç’tha dhe ç’bëri, ç’thanë
dhe ç’bënë*

f. 12

Poezi
nga

ESAD MEKULI

Mësimi i harresës

tregime nga

SHKËLZEN HALIMI

Rruga e qumështit

tregim nga

FLURANS ILIA

MIRA MEKSI

Jam shërbestare e gjuhës shqipe, të cilën e konsideroj të shenjtë

Zonja Meksi, krijimtaria juaj është e mbrujtur me elemente magjie, të mbinatyrshme, shpesh që vijnë dhe integrohen natyrshëm brenda realiteteve të njëmendta, njëlloj si letërsia e autorëve që shqipëroni, siç është García Márquez-i, me të cilin lexuesi ju ka identifikuar që prej tri dekadave tanimë. Cilat janë fillimet e krijimit tuaj të mirëfilltë? Po ato të shqipërimit? Si kanë ecur përkrah të dyja këto krijimtari letrare?

E vërteta është se nuk e kam ndarë dot përkthimin letrar si krijim, nga krijimi im letrar. Ka nisur shumë herët si një proces i pandarë që, mendoj, zanafillën e ka pasur te leximi im i pandalshëm që “përpinte” gjithçka që më dilte përpara, pa asnjë lloj kriteri, që kur lexova vetë në moshën pesëvjeçare “Xinxifillon” e Kutelit, dhe dëshira po aq e madhe për t’i ndarë me të tjerët mrekullitë e leximit. Me siguri, kjo më zhvilloi imagjinatën, sepse edhe përrallat që kisha dëgjuar apo kisha lexuar, i shndërroja në të tjera përralla të pafundme që ua rrëfeja shoqeve të mia të vogla mbrëmjeve të stërgjata të verës në bregdetin e

Vlorës, ku shkonim për pushime te gjyshërit dhe ku unë u ktheva në “heroinën” e tyre për shumë vera me radhë. Dashuria për shqipen m’u ngulit nga ime ëmë, mësuese e gjuhës shqipe, e cila e kishte traditë në familje nga gjyshi i saj, Papa Isaia, i cili kish hapur shkollë shqipe në krahinën e Myzeqesë dhe ishte po ashtu përkthyes në shqip i Shkrimeve të Shenjta. Ajo kujdesej shumë që unë t’i përzgjidhja fjalët dhe sidomos, t’i rendisja bukur në ndërtimin e fjalive. Në klasën e dytë të fillores, një vjershë për pranverën u ekspozua në stendën e klasës, ndërsa në moshën 12-vjeçare, në revistën “Yllkat” u botua tregimi im i parë “Érida dhe lulet”. Përkthimi im i parë që mund të quhet i tillë është “Princi i vogël” i Exupery-së, të cilin e bëra me një mijë mundime në vitin e dytë të shkollës së mesme, nga origjinali, sepse kisha nisur të mësoja frëngjisht shumë herët me mësues privat. Ky përkthim i parë nuk e pa kurrë dritën e botimit, por ama u bë “libri kult” i gjimnazistëve të Qemal Stafës për disa vjet. Sa për ndikimet në formimin tim kulturor dhe sidomos, në shkrimsinë time, janë disa llojesh: së

pari, sidomos Kuteli dhe Kadareja, në gjuhën tonë, por edhe Petro Marko, pak më vonë klasikët francezë, pastaj Faulkner-i, Stevenson-i dhe gjatë studimeve të fakultetit, kur kisha nisur të lexoja në spanjisht, ndërkohë që studioja për filologji frënge, u hapën për mua portat e qiellit – letërsia hispano-amerikane, nga e cila nuk do të ndahesha më kurrë, si lexuese dhe shqipëruese, dhe që mendoj është letërsia që më shkon më shumë së brendshmi.

Ka shkrimtarë të cilët kanë pohuar në shkrimet e tyre se si kanë humbur vite të tëra duke imituar një tjetër, p.sh. Borges-i, Márquez-i apo edhe Buzzat-i përmendin se si kanë ndjekur Kafkën, dhe në fund kanë gjetur shtigjet e veta. Pse ndodh kjo? A mund të dyshojmë se është një shterim motivesh, lënde letrare? Pse ky kërkim, kjo formë?

Nuk mendoj se bëhet fjalë për imitime, por për ndikime. Të arrish të imitosh një shkrimtar të madh, do të thotë të jesh në po atë nivel me të. Të gjithë krijuesit kanë mjeshtërit e tyre, ndodhen nën “magjinë” e artit të një shkrimtari të madh për ta. Fjala vjen, bota nuk e njihte Macedonio Fernandez-in, shkrimtar argjentinas, përpara se Borges-i i madh të deklaronte se ai ishte mjeshtri i tij. Vetë Márquez-i ka pohuar se është ndikuar shumë nga Juan Rulfo. Sigurisht që bëhet fjalë për prosedetë letrare, sepse, në fund të fundit, letërsia është produkt i shpirtit dhe si e tillë, sado ndikime të ketë, ndryshon nga njëri shkrimtar tek tjetri. Njëlloj si shpirti. Siç e thatë edhe ju, letërsia ime është e mbrujtur me magjinë e shkrimtarëve të mëdhenj të Amerikës Latine. E kam thënë dhe e përsëris, sidomos sjellja në shqip e këtyre mjeshtërve, më ka mësuar shkrimsinë. Kam qenë çirakja e tyre që kur përktheva për së pari në vitin 1984 për gazetën “Drita” një tregim të shkurtër të Julio Cortázar-it. Proza ime e shkurtër ka ndikime nga letërsia e Borges-it, por edhe shumë ndryshime, madje studiuesi i veprës sime Shpëtim Doda ka marrë përsipër ta evidentojë në një studim të gjatë pikëpjekjen dhe ndarjen e tregimit tim me atë të Borges-it. Një pjesë e mirë e saj i përket strukturalisht tregimit “neofantastik” që lëvroi Julio Cortázar-i. Sa për pyetjen tuaj nëse “ndikimi” lind dyshime për një shterje të lëndës letrare, më lejon të shpjegoj diçka të rëndësishme. Ndikimet nuk kanë të bëjnë shumë as me tematikën dhe as me lëndën që ngjiz letërsinë, por me mënyrën si organizohet kjo lëndë, me rrymat, stilet estetike, gjinitë dhe lëvizjet letrare. Realizmi magjik, për shembull, gjatë tërë zhvillimeve të tij ka njohur një mori të tilla. Fjala vjen, realizmi magjik i Márquez-it ndryshon nga ai i Alejo Carpentier-it apo i Carlos-Fuentes-it, por sigurisht





që kanë edhe tipare të përbashkëta. Do të doja të perifrazoja thëniet e Borges-it, të cilat e ilustronë më së miri çka thashë më sipër: shkrimtarët nuk shpikin gjësend, por vetëm zbulojnë ato që dikur i kanë zbuluar të tjerët, apo, jetojmë në një botë të përjetshme, ai që po i lexon fjalët e mia, po i shpik ato.

Përktheni nga frëngjishtja dhe nga spanjishtja. Dua të kujtoj se më 2019 keni shënuar, mendoj, kulmin në karrierën tuaj si përkthyes me sjelljen në shqip të romanit “Njëqind vjet vetmi”, që i dha Nobelin Márquez-it. Ky roman është përkthyer edhe më parë nga një përkthyes i njohur. Jeni shprehur për arsyet gjuhësore që ju shtynë t’i futeshit një pune kaq të madhe, si dhe nevojën e ripërkthimeve. Gjithsesi, shihet një lidhje shumë e madhe që keni me këtë shkrimtar, të cilin e keni takuar në fillim të viteve ’90, çka pati një jehonë të madhe në Shqipëri, ju “lulja pirate”, siç ju quajti Márquez-i. A mund të na thoni diçka që nuk e keni thënë nga ai takim? A është e nevojshme për përkthyesin të njohë tërë veprën e një shkrimtari për të përkthyer kryeveprën e tij?

Është, besoj, e qartë se “Njëqind vjet vetmi” është romani më i madh i shekullit që lamë pas. Por edhe në këta njëzet vjet të shekullit të ri nuk është shkruar ndonjë vepër e tillë. E pra, mendoni se sa e vështirë ishte, qoftë edhe për një përkthyes me eksperiencën time, që ta merrje përsipër shqipërimin e tij. Për fat të mirë, ishte një projekt në grup, që nga marrja e së drejtës së autorit nga Onufri për këtë roman (çka personalisht më

çliroi nga “barra e lules pirate”) dhe deri te redaktimi i pazakontë që redaksia i bëri përkthimit në shqip, duke e krahasuar tekstin e shqipëruar me pesë gjuhë të huaja, për të verifikuar qasjen e tyre ndaj romanit, çka solli edhe një studim të tijin mbi procesin në fjalë. Një punë e jashtëzakonshme, një eksperiencë magjike, për një vepër të jashtëzakonshme. Po, e vërtetë, takimi im me Márquez-in, përkthyesen e tij pirate në shqip (pse asokohe bëheshin botime pa të drejta autori te ne) bëri bujë të madhe në Shqipërinë e kohës. Ende nuk ishte hapur vendi. Por mendoj se edhe sot do të kishte jehonë. Lexuesi ynë e adhuron Márquez-in, ashtu si tërë bota. U përpoqa shumë për ta takuar Márquez-in që ndodhej në Barcelonë, rrugës për në Tokio, ku do të takohej me Kurosavën. Unë përktheja në shqip novelën e tij “Gjurmët e gjakut tënd mbi dëborë” në Shtëpinë e Përkthyesve në Tarazona të Spanjës. Kisha përkthyer ndërkohë “Dashuria në kohërat e kolerës”, që priste të dilte në Tiranë, dhe asokohe mendoja se takimi me shkrimtarin e madh do të më mësonte diçka më shumë për veprën e tij. Sigurisht që nuk e kam më atë mendim. Biseda jonë përmbi një orë ishte e larmishme, disa kujtime për të shoqëruan në formën e pasthënies botimin e parë në shqip të “Dashuria në kohërat e kolerës”, por edhe sot e kësaj dite mbresa më kanë lënë më tepër këshillat e tij për mua si përkthyes (nuk guxova t’i thosha që edhe unë shkruaja) e letërsisë së tij dhe kënaqësia kur mësoi që gjuha shqipe nuk kishte alfabet cirilik dhe ishte nga gjuhët më të lashta të Europës.

Kam bindjen e ngulët se duhet njohur tërë vepra

e një shkrimtari të madh, siç është Márquez-i, për të shqipëruar kryeveprën e tij. Pa e njohur atë, pa njohur nuancat leksikore të prozës së tij, mund të gabohej lehtësisht, nuk mund të përkthehej assesi lavdërueshëm “Njëqind vjet vetmi”.

Përveç mjeshtërisë së shkrimit që ju ka dhënë shqipërimi i autorëve të mëdhenj të botës, a ka ndikuar ky proces në pasurimin e gjuhës shqipe që ju përdorni?

Pa asnjë dyshim, është një nga instrumentet më efikase për të pasuruar gjuhën shqipe. Gjuhët nga përkthej janë gjuhë të mëdha dhe shumë të pasura, madje Kritika thotë që Márquez-i e ka pasuruar spanjishten. E pra, për ta sjellë në shqip prozën e tij, për të gjetur ekuivalentin e fjalëve në tërë ngarkesën e tyre leksikore, magjinë dhe drithërimin që ato bartin, më është dashur jo vetëm të kërkoj me shumë këmbëngulje për të gjetur variantin e duhur, por edhe të ngre nga fondi i pluhurosur i gjuhës fjalë të harruara, apo edhe të krijoj neologjizma. Kjo e pasuron gjuhën shqipe. Kam kohë që jam shuguruar shërbestare e gjuhës shqipe, të cilën e konsideroj të shenjtë.

Romanet *Frosina e Janinës*, *Porfida – Ballo në Versailles*, *E kuqja e demave*, *Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë*, e kanë gjetur idenë ngjizëse, idenë fillestare rreth së cilës është mbështjellë lënda e tyre, në fëmijërinë tuaj. Përpos kësaj, këto romane janë të mbushura me informacion të detajuar gjithfarësh, çfarë kanë tjetër të përbashkët?

Mendoj temën e dashurisë së penguar, pushtetin gati joshës të vdekjes, e cila shfaqet edhe si personazh, kohën labirintike, kohën e mëvetësishme të personazheve dhe kujtesën si identitet të njeriut, përpos kujtesës Universale si mozaik, ku secili prej nesh ka nga një gur kujtese në të.

Novelat dhe tregimet tuaja rrokin kozmosin, një gjeografi nga më të larmishmet, personazhe nga më të shumëllojtat, deri vetë Borges-i Márquez-i, George Sand-i apo De Musse-ja. Ato janë tekste që përmbajnë tekste të tjera, janë tekste shumëqelizore me mite, legjenda, detaje enciklopedike, shënime udhëtimesh, tipare të esesë etj., në një shtrojë fantastike apo neofantastike. Është një prozë me tipare të theksuara postmoderniste. Më ka bërë përshtypje sidomos tregimi “La gringa” (*E huaja*), pak fjalë për të, si është krijuar?

Udhëtimet janë shumë të rëndësishme për të ushqyer shkrimësinë time. I kam vënë përherë në funksion të letërsisë sime. Ka udhëtime që i kam bërë enkas për një temë të caktuar, siç ka qenë novela e Kazanovës apo e Dashnorët e Venetikut. “La gringa” bart atmosferën mitike dhe mistike të Meksikës, bukurinë halucinante të xhunglës Yucatan, rrënojat e madhërishme të tempullit të mayave Chichen-Itza, ashtu si novela “Pa zemër në kraharor”. Ende nuk kam mundur të çlirohem, nëpërmjet shkrimit, nga magjia që përjetova gjatë qëndrimit në Meksikë. “La gringa” është një zgjatim krejt i natyrshëm i romanit të Márquez-it “100 vjet vetmi”, ndërkohë që ky i fundit është i pambaruar, siç e ka deklaruar vetë autori, i cili kish menduar edhe për një brez më shumë të Buendiave. Është një lloj stafete letrare mes dy shkrimtarëve, që realizohet nëpërmjet një riti të lashtë të fiseve Maya, që vazhdon edhe në kohën e sotme sipas studiuesve – mishërimi, ku antropologia ballkanase, shtatzënë, merr pjesë. Ky tregim është edhe një paralelizëm midis vetmisë legjendare të Macondo-s te “Njëqind vjet vetmi” dhe Shqipërisë, vendit të vogël në askundin e botës, të mbërthyer nga një diktaturë e egër, e paparë ndonjëherë në jetën e njeriut. “La gringa” është shkruar në kohën kur shqipëroja “Njëqind vjet vetmi” dhe isha krejtësisht e mbushur me prozën baroke të Márquez-it, por për çudi tregimi ka një strukturë të pastër borgesiane, fraza të shkurtra, të prera, rrëfim i thjeshtë, fjalëkursyer, i mprehtë, me një fund halucinant.

Së fundmi, ka ardhur romani *Diktatori në kryq*. Cila ka qenë ideja zanafillore e tij? Si është procesi i të shkruarit të ju? Si lindin historitë, personazhet?

Përherë ka një fillesë në themel të çdo ngrehine letrare. Është e ndryshme gjithashtu kjo fillesë. Mund të jetë kujtim, përjetim, një aromë parfumi, apo edhe një ëndërr. Krijojnë ide dhe gjendje fillimisht, të cilat (shkrimtari e kupton lehtësisht) janë të afta të mbrijnë baltën në magjen e krijimit. Personazhet lindin vetë, nuk kërkohen, dhe e vendosin vetë fatin e tyre. Vërtet shkrimtarët e konsiderojnë veten si demiurgë që krijojnë botë, dhe kjo deri diku ka një të vërtetë, por nga praktika tanimë e gjatë që kam, personazhet, por edhe ngjarjet në një masë jo të vogël, u shpëtojnë vendimeve të shkrimtarit dhe krijojnë jetën e tyre. Më ka ndodhur shpesh që kam menduar një fund apo një fat të caktuar për personazhet e mia, dhe ka dalë tjetër gjë. Vjen një kohë kur shkrimtari është i ndërgjegjshëm për fillimin e shkruar (sa shumë kohë dhe mund merr incipiti i veprës) dhe fundin e imagjinuar, janë si dy ishuj që ai i sheh. Në mes ka vetëm ujë. Ky mes mbushet me ngjarje dhe popullohet me personazhe gjatë kohës së shkrimit. Është një lloj alkimie, apo magjie, që i shpëton shpjegimit me fjalë.

E kam thënë dhe e përsëris, fëmijëria ka qenë për mua “hambari” i idengjizjeve të veprave të mia. Ndodhi ndryshe me “Diktatori në Kryq”. Një kronikë televizive më nxori para syve Kishën me lashtësi drithëruese njëmijepesëqindvjeçare të Lindjes së Shën Mërisë në Labovë. Më goditi kur pashë pamjet e saj. S’kaloi pak kohë dhe shkova në Labovë për ta vizituar. Ishte kishë perandorake e ndërtuar nga Justiniani I. Brendësia e saj më la pa frymë nga pasuria e dekorit, e arkitekturës, dhe u magjepsa përpara një ikone madhështore me Krishtin Pantokrator në mes dhe *Via Crucis* përreth, ku ndenja mbi një orë duke e vështruar. Jam e rishtuar në soditjen e ikonës dhe adhurimin e saj në kohën kur shkruaja romanin “E kuqja e demave”, që fare mirë mund të quhet “E kuqja e Onufrit”. Ndjeva se një mister i madh për Krishterimin dhe fatin e njerëzimit ndodhej në atë ikonë me figura.

Ky mister ishte Graali i Shenjtë për të cilin flitet në roman?


Pikërisht. Magjia u bë më e plotë kur mësova për kryqin reliktmabajtës të Kishës së Hyllindësës, që mbante në zemër të tij një Ashkël nga Druri i Shenjtë i kryqit, ku u kryqëzua Krishti në Golgotha. Një Kryq shëronjës. Labovitët më treguan që kryqin e tyre e kish rrëmbyer e bija e diktatorit Hoxha. Kjo ishte lidhja vetëtimë që ndodhi në mendjen e shkrimtarit – diktatori dhe Kryqi.

Strukturalisht, por jo vetëm, duken të jenë dy romane brenda romanit “Diktatori në Kryq”.

Është tamam kështu, janë dy romane brenda romanit, siç e sugjeron edhe vetë titulli, ai i diktatorit dhe romani i kryqit të Labovës. Zhvillimet e të dyve, të mëvetësishme, çojnë pashmangshmërisht në pikëpjekjen e tyre për t’i dhënë hov një trilleri, i cili ka edhe një suspens policesk.

Është një roman turbullues që të lejon të futesh në intimitetin e mendjes dhe shpirtit të një diktatori. Nuk ka gjer më sot në letërsinë shqipe një veper letrare që të trajtojë figurën e diktatorit. Përse ju tërhoqi një figurë e tillë?

Letërsia ka kohën dhe ligjësitë e saj që nuk përkojnë me ato të shoqërisë njerëzore. Nuk është aspak çudi që edhe pse kanë kaluar tridhjetë vjet nga rënia e murit të Berlinit, nuk është kthyer në *topos*, në subjekt letrar, figura e diktatorit Hoxha. Përherë më ka interesuar marrëdhënia e një njeriu të fuqishëm, me një pushtet të madh, që e krahason veten me perënditë e qiellit, me vdekjen, pasvdekjen dhe përjetësinë e tij. E kam trajtuar te romani im i parë “Frosina e Janinës”. Ali Pashai dhe përjetësia e tij. Me këtë roman mëtova të ndërtoja stereotipin e diktatorit të shekullit që lamë



pas dhe që u karakterizua nga tipare që nuk i gjejmë te prijësit, udhëheqësit apo satrapët e dikurshëm. Këta të shekullit XX, përpos të tjerash, akaparuan edhe pushtetin e artit, shkruan vetë vepra letrare, shpikën një “model” letërsie, të cilin u përpoqën t’ua diktonin gjakësisht artistëve dhe shkrimtarëve...

“Diktatori në kryq”, në ditët e fundit të jetës së diktatorit, e çmitizon atë, deri hyn në intimitetin e tij romantik, në dashurinë e tij për infermieren Lumka. Ai kërkon një mundësi të dytë në jetë, një rikthim nga vdekja. A është penduar diktatori për gjithë çfarë u ka bërë shqiptarëve? A po kërkon të ndreqë gabimet e tij?

Kam zgjedhur ditët e fundit të jetës së tij, kur diktatori është i ndërgjegjshëm për vdekjen e afërt, pikërisht për të pasur një panoramë të plotë të përsiatjeve të tij mbi tërë jetën që tani është në fund, të përballjes së tij me vetveten, të njohjes së fajeve,



krimeve, tmerreve që ka kryer. Jo, diktatori nuk është penduar. Por, duke krijuar një pushtet absolut, ka krijuar pashmangshëm edhe vetminë e tij të tmerrshme. Ndjenjën më të bukur për njeriun, siç është dashuria, e ka këmbyer me një ideologji që do t’i siguronte pushtetin. Nuk është më ai njeriu i fuqishëm që njeh bota, por një njeri i sëmurë, i pafuqishëm, i frikësuar për vdekje jo nga vdekja, por nga pabesia e njerëzve që ka pranë. Në fund të fundit, është njeri që ka edhe dobësitë e tij, që kërkon të rikthehet për t’i bërë gjërat ndryshe. Ky është edhe misteri më i madh i njeriut dhe jetës njerëzore. Dashuria që ai ndien për Lumkën, infermieren e re, e vetmja gjë e pastër në fëlliqësinë e botës ku jeton, është fijeza e hollë e shpresës, fija e barit ku kërkon të mbahet ai njeri që po mbytet në detin e së keqes dhe të tradhtisë, në detin e luftës së egër për pushtet.

Ironia, satira, humori i zi, janë tipare të rëndësishme të “Diktatori në Kryq”, duke treguar se kemi të bëjmë me tipare postmoderniste.

Janë në funksion të ideve që përçohen në roman. Diktatori shkërben vetë Krishtin në skenën e ekzekutimit të klerikut të gjorë, kur po kërkon të vërë në provë shenjtërinë e Kryqit dhe virtytin e tij të ringjalljes. Atij i duket vetja si Krishti. Është absurde dhe qesharake hipokrizia e diktatorit që bëri plojën më të madhe me fenë e shqiptarëve dhe kërkon shpëtimin e shpirtit pikërisht prej saj.

Në tiparet e tij postmoderniste ky roman ka ngjashmëri me romanin e García Márquez-it “Gjenerali në labirintin e tij”.

Bëhet fjalë për një metafiksjon historiografik në gjuhën e kritikës letrare, që do të thotë një fiksionalizim apo trillëzim të historisë, të një figure apo ngjarjeje historike. Po, në romanin që përmendët, Marquez-i ka kthyer në fiksjon, në trill, figurën e Simon Bolivarit. E njëjta gjë vlen edhe për figurën e Enver Hoxhës në “Diktatori në Kryq”.

Radhët e gjata janë bërë të zakonshme tanimë në Panairin e Librit për të marrë autografin tuaj. Po kështu ndodhi edhe këtë Panair me “Diktatori në Kryq”. Márquez-i është shprehur se i pëlqente një marrëdhënie private mes lexuesit dhe librit.

Marrëdhënia lexues-libër është përherë një marrëdhënie private, intime. Nuk ndodh ndryshe. Siç jam shprehur edhe më parë, lexuesi ka shumë rëndësi për jetën e librit pasi ai del nga dora e shkrimtarit në treg. Lexuesi i mirë, nëpërmjet leximit që nënkupton interpretim, e bën atë të gjallojë. Sa më shumë lexime-interpretime të ketë, aq më shumë jeton ai libër. Prania e shkrimtarit në Panair, autografi që ai vendos në librin e lexuesit të mundshëm, jo blerësit, është mendoj një lloj garancie, një lloj materializimi në sytë e lexuesit, e atij që po bëhet gati t’i tregojë një histori. Është një lloj garancie besimi edhe vendosja e një marrëdhënieje midis librit, lexuesit dhe autorit. Sepse pas marrjes së autografit, libri nuk është më mall për një lexues anonim, por për një lexues me emër dhe mbiemër. I dedikuar. Them se kjo e ndihmon leximin. Nga ana tjetër, ndonëse është e mundimshme për shkrimtarin, është një e dhënë për trendin e lexuesit të tij. Në këtë Panair Libri kishte shumë të rinj që morën “Diktatorin në Kryq”, çka më tregoi tendencën që krijon një tematikë e caktuar. Nga ana tjetër, duke parë numrin në rritje të lexuesve të mi vit pas viti, jam bërë më e kujdesshme, më kërkuese, në shkrimësinë time.

Dhe pyetja e fundit: si ndodhi që vendosët si fjalinë përmbyllëse të romanit tuaj, fjalinë e fundit të “Njëqind vjet vetmi”?

Ndoqa, në të vërtetë, një traditë që vetë Márquez-i e ka bërë dikur në nderim të Juan Rulfo-s, mjeshtrit të tij të letërsisë. Një nderim për librin që çmoj më shumë në letrat botërore gjer më sot, “Njëqind vjet vetmi”.

Shënim për romanin "Dëmtuar gjatë rrugës" të Besnik Mustafajt

Të rrëfesh nga sytë e një foshnjeje


nga Namir Lapardhaja

Për Italo Calvinon saktësia në letërsi ka tre elemente të rëndësishme: një skicim të veprës së përcaktuar dhe të përlogaritur mirë; evokimin e imazheve të dukshme, që të nguliten në kujtesë dhe një gjuhë të saktë, si leksik dhe si dhënie e kuptimeve të mendimit dhe të imagjinatës.

Mbi parimin e saktësisë është ngritur romani i Besnik Mustafajt, "Dëmtuar gjatë rrugës". Si personazh modern, autori e shpreh që në faqen e parë arsyen e shkrimit. Ai tregon se historia që do të rrëfejë është mbajtur gjatë si një tumor në kokën e nënës së vet, për tridhjetë vjet, kurse ai po e shkruan me dëshirën e saj, madje, ashtu siç ai thotë, me urdhërin e saj, por krejt me stilin e tij. Në pak rreshta duket sikur plotësohet i gjithë përfytyrimi i saktësisë së rrëfimit, i cili, pavarësisht se niset nga një fakt i vërtetë, përgjatë gjithë romanit ruan autencitetin autorial.

Rrëfimi duket se realizohet nga sytë e një foshnjeje që është gjithmonë aty për të treguar ngjarjen, e cila si kohë letrare është vendosur diku në vitet '60, kur Shqipëria komuniste është në marrëdhënie të mira me Bashkimin Sovjetik, në krye të së cilit ka ardhur Nikita Hrushovi. Fabula e romanit është e thjeshtë, kurse galeria e personazheve e kursyer: Shoqen S., nënën e foshnjes që rrëfen, e thërret vet Sekretari i Parë i Partisë në zyrë. Gjatë këtij momenti dhe tregimit të arsyes se pse e kanë thirrur në zyrë, në kokën e gruas qarkullojnë një shumësi aludimesh nga më të çuditshmet. Në momentin e takimit të saj me zyrtarin e lartë të zonës veriore, i bëhet e qartë një arsye, në dukje, banale: kërkohet punimi me dorë i një palë opingave, që të jenë një kryevepër e vërtetë artistike. Për realizimin e kësaj kryevepre asaj i ofrohet çdo gjë në dispozicion përveç kohës: vetëm dy ditë. Gjithçka duhet realizuar në sekret të plotë, madje aq diskret saqë asaj nuk i jepet ndonjë shpjegim më tepër përse i përket atij që do t'i vishte opingat, do të ishte femër apo mashkull, çfarë moshe, numri i këmbë etj. Mes dilemave të mëdha në vetvete, gruaja e realizon atë që i kërkohet. Kur gjithçka zbulohet se ato opinga do t'i dhurohen Hrushovit gjatë vizitës së tij në Shqipëri, për gruan e re, shtëpiake dhe të pamësuar me jetën jashtë avllisë, fillon një histori e re e një "ylli në ngjitjeje" në karrierën partiake. Ajo do të dekorohet nga vetë udhëheqësi komunist i vendit me "yllin me pesë cepa" dhe do të shërbejë si model i lartë frymëzimi për gratë e tjera të zonës, madje dekoratën do të vijë t'ia dhurojë vetë Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Pikërisht mes këtij momenti dhe rënies së saj në çastin e prishjes së vendit tonë me Bashkimin Sovjetik ndodhin një shumësi ngjarjesh që mbushin faqet e romanit. Përshkrimi psikologjik i botës së brendshme të shoqes S., dilemat e mëdha, monologu dhe zërat e brendshëm, ëndrrat dhe përjetimet, marrëdhëniet me vjehrrin, burrin dhe shoqet e partisë, por edhe me njerëz të shpallur apo armiq në dispozicion, ndërthuren mes njëra-tjetrës, ku na japin një vepër të mirëfilltë artistike. Romani ka formën e një testamenti të pashkruar të nënës së shkrimtarit, i cili, ashtu siç shprehet ai gjatë ndërhyrjeve të herë pas herës si zë autorial në roman, duhet t'i jepet bashkëshortit të saj në gjallje për të parë vuajtjet e mëdha gjatë "transformimit" të saj nga një shtëpiake në një yll në ngjitje në karrierën partiake.

I gjithë rrëfimi është përqëndruar tek karakteri psikologjik i nënës së autorit, të cilin ai e ka realizuar me mjeshtëri, duke i tejkaluar notat autobiografike dhe duke u kapur fortë pas parimeve të letraritetit. Nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë dhe leksiku të zgjedhur, ai ka arritur t'i japë lexuesit imazhin e personazhit të tij, duke e futur atë thellë në psikologjinë e brendshme, duke i lexuar mendimet e duke u futur në ndjenjat e saj më të fshehta.



ÇMIMET KULT 2019



LIBRI ARTISTIK I VITIT:
Diana Çuli me "Vrasje në Kryeministri"



PËRKTHIMI I VITIT:
Parid Teferiqi me "Dita e mbetur"
nga Kazuo Ishiguro



LIBRI ALBANOLOGJIK I VITIT:
Pranvera Bogdani me "Balshajt"

KËNGA E VITIT:
Anxhela Peristeri me këngën "Pa Mua"

INTERPRETUESI LIRIK I VITIT:
Armando Likaj me Escamillo në Operën "Carmen"

INSTRUMENTISTI I VITIT:
Ali Pengili, Oboe me Koncert për oboe Nr.2 (sol minore) nga Ludwig August Lebrun

BALERINI I VITIT:
Fatjon Lito me Albert tek "Zhizel"

MONO-DRAMË/ KOMEDIA E VITIT:
Olta Daku me "Shirli Valentina"

AKTORI I VITIT:
Koço Qendro me Harpagoni tek "Kopraci"

AKTORJA E VITIT:
Luiza Xhuvani me Medea tek "Medea"

DOKUMENTARI I VITIT:
Eno Milkani me "Atentatet e mëdha"

REGJIA E VITIT:
Ema Andrea me "Natën, Má!"

ARTISTI PAMOR I VITIT:
Kristo Krisiko me "Prolog epilog"

DIELLI, DHE NJË POEMË QË SPEKULLON ME TË

(Shënime kritike nga dhjetë gjimnazistë
– gazeta “Shkëndija” 25 janar 1973)

Nuk na e priste mendja se Faslli Haliti do të shkruante një poemë të tillë si “Dielli dhe rrëkerat”. Ajo është frut i një çoroditje politike e ideologjike dhe na jep një pasqyrë në themel të shtrembër të realitetit tonë, të natyrës së pushtetit popullor dhe të marrëdhënieve të partisë me popullin. Ky karakter i shtrembër ideologjikisht nis që me vargjet e para të poemës, në të cilat thuhet:

“Ndërsa çatia e atdheut tim është e kaltër, optimiste. Çatia e shtëpisë time është qaramane”.

Ç’kuptim kanë këto vargje? A nuk është “çatia e atdheut” vetë çatia e popullit? Dhe, po ta zhveshim mendimin prej figurës, a nuk ndërtohet socializmi në Shqipëri nga populli e për popullin, a nuk është qielli ynë “i kaltër dhe optimist” për të gjithë ata që luftojnë e punojnë me popullin e për popullin? Vështrimi i F. Halitit në këtë poemë është errësuar dhe kërkon (bile jep edhe “urdhër”) që edhe në të tjerët të shikojmë një tabllë të errët dhe t’i bëheshin shokë në pikëpamjet që ai shpreh në këtë poemë. Ai mendon se nga tavani (i kujt: i vetë poetit apo nga tavani i popullit?) “lot gjerbësh rrjedhin vu, vu... nat’ e ditë, rrjedhin me të madhe”. Sipas poemës të gjithë qenkan keq dhe njerëzit e pushtetit flekan gjumë të rehatshëm, iu mbyllkan dyert e zyrave punëtorëve, shtrëngokan buzët, strehokan “soj e sorollopën” e tyre dhe paskan degjeneruar deri në atë shkallë sa për “një cigare filtër, një rekomandim” u venë përpara të njohurve “një apartament”. Nga e gjithë poema del se pushteti ynë qënka burokratizuar deri sa nuk mban më, se askush nuk i qan hallet e popullit, se punëtorët duhet ta rregullojnë vetë strehën e tyre dhe në poemë u jepet “urdhër” atyre që t’u thejnë “dhëmballët burokracisë” dhe po u munguan gurët të shkulin dhëmbët e nëpunsave. Si t’i marrim të gjitha këto, si vargje figurash të bujësme, apo si pikëpamje të gabuara për realitetin tonë revolucionar? Jo, ato nuk tingëllojnë aspak drejtë në luftën kundër burokratizmit, flamurin e sëcilës e mban kurdoherë partia, por gumëzhijnë për anarshi dhe rebelizëm.

Që të kthehemi prap tek figurat artistike, në poemë si përfaqësues të vetëm të pushtetit dalin shoku Koli dhe shoku Lili, të cilët sikurse “uni i poetit” nuk mund të mos jenë përgjithësime artistike dhe këto përgjithësime janë negative. Në poemë, për realitetin konkret për të cilin flitet, autori nuk na jep asnjë të drejtë të mendojmë se ata janë “tipa të rastit” dhe as përjashtime nga gjëndja e përgjithëshme, prandaj edhe mendon, se “shkretëtira e kontradiktës” nuk mund të zgjidhet as me shokun Lili, as me shokun Koli. Pa shihni se ç’rrugë propozohet?! Duke u nisur prej aksioneve revolucionare për ndërtimin e banesave me kontribut vullnetar, autori i poemës, duke injoruar të vërtetën, mendon këtu se asgjë nuk është bërë për punëtorët, se atyre u është përvetësuar djersa. A nuk është shpifje me qitje të largët kjo? A nuk kalohet prej luftës kundër burokratizmit nga pozitat e partisë në pozitat e kundërvënies ndaj pushtetit popullor? Fundi i poemës tingëllon pikërisht kështu.

Madhështia dhe forca e partisë sonë është se ajo ka farkëtuar njëunitet të çeliktë me popullin. Në Shqipëri

nuk ekziston një parti që rri e numuron gjerbat, që trishtohet në mënyrë sentimentale për hallet e njerëzve dhe që rri pa gjumë prej “melodisë diletante të pikave, po një parti luftëtare që udhëheq popullin në revolucion dhe është kurdoherë në veprim për të mirën e masave punonjëse. Çdo gjë tek ne është vepër e partisë, e shokut Enver dhe e gjithë popullit. Partia realizon çdo ditë dhe kudo demokracinë socialiste dhe drejtësinë për popullin, duke qëndruar pranë tij, duke qarë hallet me të, duke e bërë atë të ndërgjegjshëm. Përballë kësaj të vërtete të madhe autori ka mbyllur sytë dhe ka krijuar në poemë një përfytyrim subjektivist krejt të dyshimtë mbi marrëdhëniet parti-popull-pushtet, duke u orvatur të krijojë të çara për të futur kontrabandë pikpamje anarshiste mikroborgjeze. Sipas poemës askush nuk bën gjë, kështu që i mbetet “unit të poetit” të japë “urdhërin”: “Thejani dhëmbët burokracisë!” Ky është një shtrembërim flagrant i së vërtetës, që e ka burimin në mentalitetin e vjetër e tërë të çara të autorit, që ose shitet shumë “naiv” në politikë, ose është prej atyre që shfrytëzon situatat revolucionare për të nxjerrë në shesh kundërshtimet e tij prej mikroborgjezi. Pra, ndërsa “fle shoku Lili... fle shoku Koli”... në këtë situatë (autori është kontradiktor, në gjithë këtë konfuzion ideologjik, poema nuk di cilës shpifje t’i hapë portën më parë) shoku Lili dhe shoku Koli prashitin si të duan dhe “qindra këkesat” e punëtorëve “thejnë kokat” se “nuk hyjnë dot” në zyrat e tyre.

A është kjo e vërteta e jetës sonë socialiste? A mund të shkruhet kështu për partinë dhe klasën tonë punëtorë? A kemi nevojë ne për një poezi që të na gënjejë me lajka për partinë, që të shikojmë me dyshim realitetin dhe të na bëjë thirrje të ngrihemi kundër tij? Jo, për një poezi të tillë nuk kemi nevojë. Ne e hedhim poshtë atë me përbuzje dhe jemi të bindur se vjersha të kësaj natyre, të servirura me çfardo dredhirash e marifetesh stilistike, kurrë nuk do të mund të spekullojnë dhe ta errësojnë diellin e jetës sonë.

Poema “Dielli dhe rrëkerat” botuar në gazetën “Zëri i Rinisë” të datës 16 dhjetor 1972, na kujtoi se ky konfuzion ideologjik ka pasë nxjerrë kokë edhe në

krijime të mëparshme të F. Halitit, me të cilat ne nuk kemi qënë dakord. Mjaft vjersha të tij ideologjikisht të gabuara apo gjysëm formaliste që lexonin nëpër faqet e organeve letrare (duke u çuditur si botoheshin) ne na revoltin. Prandaj për këtë poemën e fundit, është kjo arësyeja që menduam se do të gabonim sikur të heshtnim më gjatë.

Sa për mendimin që është hedhur se F. Haliti në poezitë e tij shquhet për prirjen që shkrin në një të vetme personale me shoqëroren, do të mjaftonte dhe një ballafaqim fare i shpejtë i egocentrizmit dominues në krijimtarinë e tij me faktet nga çështjet e tij personale, për të hedhur poshtë këtë “prirjen e shkrirjes”. Përkundrazi, ai, me personalen i kundërvihet shoqërores dhe pikërisht këndej fillon çoroditja, duke i vënë së përgjithshmes revolucionare vulën e personale mikroborgjeze. Për këtë le të marrim rastin e poemës që po diskutojmë.

Ne të gjithë e dijmë që F. Haliti ka trashëguar prej paraardhësve të tij një shtëpi të vjetër të madhe në qendër të Lushnjës, të cilën deri para pak kohe dhe për disa vjet rrjesht nuk ka dashur ta këmbëje me apartament modern. Siç tregojnë faktet, këtë nuk e ka bërë “për sentimentalizëm”. Se “as babai, as mamaja nuk ishin sentimentale”, po për t’ia shitur pushtetit popullor me pare “mallin e trashëguar” Ai pengoi për dy vjet e sa rrjesht ngritjen e një pallati të ri në vënd të karakatinës së tij përballë kinoteatrit që po përfundon në qendër të qytetit. Nuk u tund e nuk pranoi asnjë lloj strehimi për derisa futi në xhep shumën e parave me të cilën u vlerësua shtëpia e tij. Jo vetëm kaq, por kundërshtimet e tij arritën deri aty sa të pretendonte t’i jepej një vilë më vehte. Më në fund mezi pranoi të marrë një apartament. Prandaj nëqoftëse pikënisja personale e poemës është kjo histori prej xhambazësh, atëhere ne do të thoshnim se jo vetëm që nuk ka asgjë nga “shkrirja e personale me shoqëroren”, por këtu shtrembërohet e vërteta, dhe autori bën gabim kur e vë vehtën në një radhë me traktoristin “që zbukuron fushat me traktorin e tij”, me elektrikistin “që elektrifikoi disa fshatra”, dhe me muratorin që “ka zbukuruar qytetin me pallatë”, se punëtorët as mendojnë as veprojnë si F. Haliti dhe, qoftë edhe si personazhe, u vjen turp të vihen në shërbim të egoizmit mikroborgjez, që shprehet në poemën “Dielli dhe rrëkerat” duke e analizuar atë qoftë në planin e karakterit përgjithësues të figurës artistike dhe të “unit të poetit”, qoftë në planin e thjeshtë personale.

Pa u çliruar sa s’është vonë nga individualizmi mikroborgjez F. Haliti nuk mund të na japë poezi të shëndosha të realizmit socialist, por përkundrazi ashtu siç vihet re nga ecuria e krijimtarisë së tij, ai ka rrezik të thellohet në çoroditjen ideologjike dhe atëhere do të jetë tepër vonë.

EMRAT E 10 -të GJIMNAZISTET I FSHIVA
NGA KRITIKA SI TE MANIPULUAR
NGA KOMITETI I PPSH SE RRETHHIT.





FASLLI HALITI

Dielli dhe rrëkerrat dhe një poemë që spekulon me të

(Siç është botuar në "Zëri i Rinisë")



Ndërsa çatia e atdheut tim është e kaltër, optimiste
Çatia e shtëpisë sime është qaramane.
Shtëpia ime është sentimentale,
Dy re në qiell
Ajo vu lotët,
Dy re në qiell
Ajo vu me të madhe.

Nga sytë e tavanit tim
(Tavani ka dhjetëra sy)
Lot gjerbësh rrjedhin vu, vu,
vu, vu
Natë e ditë
Rrjedhin me të madhe
rrjedhin
Pi-
kë,
Pi-
kë,
Jorganët e mi
Si jorganët e një personazhi melodramatik,
Mbytur në lot gjerbësh të verdha
Librat e bibliotekës sime
Me faqe të përlostura nga gjerba

Beni,
Blerta,
Zamir!
Këto faqe librash
Kur t'i lexoni
Pas viteve shtatëdhjetë
Mos i merrni për lotët e mamasë'
Mos i merrni për lotët e babait këto gjerbë.
As mamaja,
As babai
Nuk ishin sentimentale,
Sentimentale qe shtëpia jonë
Sentimental ishte tavani i saj,
(megjithëse dhe shtëpia dhe tavani ishin frymë e vjetër
Dhe s'kishin shumë faj.)

Në çdo faqe objekti të dhomës sime-gjerbë...
Në çdo faqe objekti
Një figurë abstrakte e verdhë.

Dy gjëra s'ka prekur gjerba në shtëpinë time:
(I kam siguruar ato të dyja në qoshet e shtëpisë)
Portretin e Enverit,
Historinë e Partisë.

Çatia ime sentimentale,
Dy re në qiell-
Ajo vu lotët,
Dy re në qiell-

Ajo vu me të madhe.
Nga sytë e tavanit tim
Rrjedhin lot gjerbësh vu, vu,
Vu,
Vu,
Natë e ditë,
Rrjedhin me të madhe,
Rrjedhin
Pi-
kë,

pi-
kë!
Janë dadot tona,
Janë gjyshet tona
Këto pikë,
Këto gjerbë
Që na vënë në gjumë,
Me zërin e tyre të verdhë
Dhe për çudi,
Këto gjerbë,
Këto pikë
Vënë në gjumë edhe shokun Lili
(Shefin e strehimit në komitetin ekzekutiv.)

Jashtë erë,
Jashtë shi,
Kurse gjerbët heshtin tashti!

Zgjoj gruan,
Fëmijët i zgjoj
Dhe mes gjerbave të verdha, familjarisht,
I drejtohem Enverit,
I drejtohem Partisë:

Mos rrini fare të menduar!
Ne për ju flemë edhe në ujë,
Ne për ju flemë mbi dyshekë akujs,
Ne për ju flemë dhe me çarçafë dëborërash mbuluar!
Ne për shokun Lili na vjen keq
(Shefin e strehimit)
Ne për shokun Koli na vjen keq
(Kryetarin e këshillit)
Që në pallatin e ri që mbaroi
Nuk na caktoi ne,
Nuk caktoi traktoristin Qazim Gjoni,
Nuk caktoi elektrikistin Met Myzeqari,
Nuk caktoi muratorin Llazi Lala;
Nuk caktoi arkitektin Koço Mina,
Por
Soj -
e
soro-
e llopin e tij caktoi.

Soj-
e
soro-
e llopin e tij
Që dezertoi nga fshati.
Që la shtëpinë në fshat,
Që erdhi nga fshati tashti
Dhe i pari mori hyrje në pallat.

Qazimi zbukuron fushat me traktorin e tij,
Qazimi në një dhomë u bë dhëndër,
Qazimi në një dhomë bëri shtatë fëmijë.

Met Myzeqari elektrifikoi disa fshatra,
Meti në qindra dhoma dhëndurësh vuri llamba.
Dhe gjeti një nuse në fshat,
Një nuse si shtyllë elektrike,
Një nuse të bukur syllambë,
Por Meti ende rri fejuar
Për një hyrje, shoku Lili,



Vizatim nga Bujar Kapllani

Elektriciisti Met ende s'është martuar.

Muratori Llazar
Ka zbukuruar qytetin me pallate,
Por Llazi ka disa vjet
Që rri në një barakë pupuliti 3 me 3
Me gruan, nënën, fëmijët, vetë i tetë.

Kurse kushëriri yt,
Ka një hyrje, shoku Lili,
Ai dhe gruaja, vetë i dytë.

Shoku Lili,
Shoku Koli,
T'u ankua Qazimi, Meti, Llazari,
Të erdhi Qazimi, Meti, Llazari,
Në zyrë,
Në komitet?
Dhe mos mendoni se ishin të ndrojtur,
Mos mendoni se ishin leshko,
Mos kujtoni se s'e dinin që kishin të drejtë!
Jo!
Ata e dinin që kishin të drejtë,
Por i mbanin hatrin Partisë,
Që strehimin s'e ka të lehtë.

(Vijon në faqen 9)

Ju me sakrificën e tyre keni abuzuar
Dhe vite me radhë s'i keni strehuar.

Jashtë erë,
Jashtë shi,
Ne flemë,
Na zë gjumi prapë,
Fle dhe shoku Lili
(Shefi i strehimit),
Fle shoku Koli
(Kryetari i këshillit)
Partia
Enveri

prapë zgjuar rrinë
dhe vënë dorën dorën aty ku pikon,
dhe s'ka gjerbë që s'e dinë !

Dhe jo vetëm e dinë
Aty ku rrjedh
Aty ku pikon,
Hapin themele
Hedhin çatinë.


Shkretëtira e kontradiktës së strehimit
Bëhet lëndinë.
Nën shiun e djersës së klasës punëtore
Lulëzojnë lule pallatesh pambarim.

I këputën lulet e apartamenteve:
Nr. 1
Nr. 2
Nr .3

I ndamë
Numër 1
Ia dhamë shokut Qazim
Numrin 2 shokut Llazar,
Numrin 3 shokut Meti ia dhamë.

Në vend të shushurimës së gjetheve,
Në vend të erës së luleve,
Brenda petaleve të mureve të pallatit të ri,
Dogjo të qarat e vajzës së Metit,
Dëgjo të qeshurat e vajzës që lindi,
Dëgjo ninullat e nuses së Metit,
Shoku Koli
Shoku Lili.

Për një hyrje,
Për një hall,
Ne trokisnim tek ju,
Trokisnim në portat e buzëve tuaja,
Me gishtin e halleve tona trokisnim,
Shoku Koli,
Shoku Lili;
Portat e buzëve tuaja s'hapeshin
Dhëmbët tuaj kyçeshin
Me nervozizëm kërcisnin.
Vinte miqësia,
Hynte pa trokitur,
Vinte shoqëria, hynte pa trokitur,
Portat e buzëve hapeshin vetë,
Muret e dhëmbëve shkëlqenin.
Qindra kërkesat tona thyenin kokën,
Nuk futeshin dot,
Nuk i hapnim dot.
Një trokitje miku,
Një trokitje shoku,
Një cigare me filtër,
I hapte fare lehtë.
Një rekomandim,
Miku,



Vizatim nga Helidon Haliti

Shoku,
Një porosi
Shoku,
Miku
Përpara ju vinin ata
Ju vinin përpara një cigare, një paketë.
Ju-
Një hyrje iu vinit atyre përpara
Një apartament.

Shtëpia ime sentimentale
Vazhdon të qajë,
Të pikojë,
Të gjerbojë.
Por
Në secilën pikë të shtëpisë sime,
Në secilën gjerbë,
Ne po hapim nga një themel
Nga një pallat të ri vigan po ngremë.
Në truallin e shtëpisë sime sentimentale,
Ne po ngremë një lagje të re vigane.

Shkretëtira e kontradiktës së strehimit
Do të bëhet një qytet i ri banimi.

Urdhër!
Me grushtin e klasës punëtore
Thyejani dhëmbët burokracisë!
Thyejani dhëmbët shokut Koli,
Shokut Lili!
Po ua thyejmë,
Na duhen gurë,
Makinat në gurore u vonuan.
Po i murosim dhëmbët tuaj.
Ne s'mund të rrimë pa punë
Ne s'mund ta lemë me duar nën gjerbë
Enverin,
Partinë,
Ne i kemi piketa duart e tyre,
Piketa ku duhet të hapim themele
Piketa ku duhet të heddim çatinë.
Partia,
Enveri
Zgjuar rrinë?!
Dhe vë në dorën ku pikon?!
Dhe s'ka gjerbë që s'e dinë?!

Si s'ka gjerbë që s'e dinë?!

Sapo u kthye nga shkolla në mesditë ndër të parat
sende që i zuri syri në korridor ishte bidoni i
boshatisur i qumështit. E priste për t'u rimbushur.
Kjo do të thotë, përpara se të filloj dhe studioj
matematikën, që e kishte provim ditën e nesërme, do
t'i duhej të shkonte së pari në fshat - për të siguruar
qumështin!

Kishte disa muaj që fshatarëve reforma e Ramiz
Alias u kishte dhënë të drejtën për të mbajtur një lopë
në shtëpi. Ndaj çdo dy-tre ditë shkonte në një fshat
ngjitur me qytetin, te një familje që i lidhnin veçse
lidhje të ngushta *Qumështore* ...

Historia e radhëve të gjata nëpër qytete ishte drejt
fundit. Ndërmarrjet shtetërore ushqimore duke shkuar
drejt falimentimit nuk i plotësonin më kërkesat e
qytetarëve. Kështu me bidonin e lidhur në timonin e
biçikletës ai përshkonte qytetin e nëpër rrugë periferike
u drejtohej fushave të djerra gjersa mbërrinte në fshatin
Dyshnik, për të blerë qumështin e fshatarëve. Kishte
kohë që e bënte këtë. Kishte kaluar gjysmën e fëmijërisë
së tij nëpër radha, sepse vëllai tij i madh kishte një
vajzë të vogël. I takonte pikërisht atij si shkollat dhe
i pa punë që të kryente këtë detyrë kundrejt familjes
dhe mbesës së tij që e donte aq shumë. Pra si më i vogli
i shtëpisë - bidoni i qumështit ishte pjesa e pandarë
e ditëve të tij. Ishte një rob. Thjesht një ushtar NË
SHËRBIM TË QUMËSHTIT. SIGURIMI I
QUMËSHTIT NË FAMILJE ishte misioni që duhej
kryer pa as më të voglin kundërshtim. I dinte të gjitha
rrugët më të shkurtëra PËR TË MBËRRITUR
GJER TEK QUMËSHTI.

Por sot i duhej të nxitonte për arsye të forta. Së pari
e gjithë familja kishte shkuar në maternitet ku priste
lindjen e fëmijës së dytë të vëllait. Ngaqë kishte rënë
shumë shi dhe pritej nga çasti në çast t'ja rifillonte
përsëri, ai pedalonte me sa fuqi që kishte që të mbaronte
punë sa më shpejt. I shtytur për më tepër edhe prej
atij provimi të mallkuar të matematikës që ç'është e
vërteta e urrente sepse asnjëherë nuk kishte qenë një
nxënës shembullor në përllogaritje matematikore.

Në hyrje të Dyshnikut pikat e para të trembura të
shiut filluan. Gjysmë i lagur u fut nën strehën e portës
ku në plevicën kashtore bri së cilës një lopë e madhe me
cica të fryra qëndronte në oborrin e shtëpisë. Tek-tuk
pula qafërrjepura hidheshin mbi gardhe me kakarritje
rraskapitëse për t'u futur nën strehë.

- Mirë se erdhe djalë, qenke lagur nga shiu. Eja
brenda të marrësh një të tharë, - e ftoi e zonja e
shtëpisë, një amvisë me gjinj si Junona kur lindi
Kashtën e Kumtrit.

- Jo zonja Sheqere - i tha me droje - dua të kthehem
pa më zënë rrebeshi.

Sheqerja, gruaja me mollëzat e faqeve si një qepë
e kuqe Korçe, e tërhoqi brenda dhe filloi të mbushte
bidonin me qumësht nga kusia prej ku sapo e kishte
vluar. Asnjëherë nuk i kishte numëruar saktësisht
tufën e madh të fëmijëve të Sheqeres, të cilët hynin e
dilnin nga të gjitha vrimat e gardheve të shtëpisë, duke
e bërë gjithnjë lëmsh numërimin e tij. Ishte i bindur se
ajo amvisë kishte ushqyer me ato gjinj të saj universal
një ushtri me kalamaj. Ajo grua të krijonte idenë fikse
sikur mbante amësinë e të gjiithë atij fshati. Madje të
të gjiithë asaj krahine, e më tej ...

Njëri prej fëmijëve, një sybardhë që i lëpinte shpesh
qurret me gjuhë, sa herë që ai vinte në fshat nuk ia
shkulte sytë biçikletës së tij. I kishte thënë se, kur të
rritej do ta blinte një të tillë. Shpesh në kohë të thata ja
linte ndonjë xhiro dyrrotëshen aty tek qendra e fshatit
përkasht zyrave në kapitullim e sipër të kryesisë. Me
mburrje sybardhi nga krenaria për ta parë shokët e vet
i hiqte duart nga timoni dhe lëshonte thirrje hareje

RRUGA E QUMËSHTIT

tregim nga

FLURANS ILIA

nëpër qiellin e hasdisur. Sapo e shihte ndërsa vinte për të blerë qumësht, “syçka” ndihej i lumturuar dhe nuk i shqitej pa ja kërkuar një xhiro biçikletën. Por, sot nuk e pa rreth-e-qark. Sybardhi ishte i sëmurë. I platitur në shtrat marroku digjej nën temperaturë. E pa nga porta gjysmë e hapur e kuzhinës të mbështjellë me një batanije ngjyrë bërsi me cepa të grisur. Ia bëri me dorë. “Syçka” instinktivisht bëri të ngrihej, por u step një çast. Brenda syve bardhosh regëtinin thëngjij të padukshme përvëlues.

Pasi e vendosi se duhej të shkonte, i dha përshëndetjet e përzemërta Sheqeres dhe fëmijëve të saj. Menjëherë rrëmbeu timonin e biçikletës në krahun e djathtë të së cilit e lidhi fortë bidonin e mbushur me qumësht.

Shkreptima frikësuese përshkonin qiellin duke zbritur horizonteve të arave djerrë. Pas tyre, bubullinte me aq forcë, sa me timonin e salduar fortë ndër duar, turravrapthi u lëshua drejt rrugës plot baltë, ujë dhe gurë, që lidhte Dyshnikun me rrugën ndërqytetare. Ishin gati dy-tri kilometra për të përshkuar gjersa të mbërrinte në asfalt. Timoni i dridhej ndër duar dhe rrotat rrëshqisnin nëpër baltë. Pedalonte në krahun e djathtë, bri të cilit rridhte një kanal, Kushova. Një përrua që vinte shpesh në kohë shtrëngate, dhe përmytje arat buzë fshatit dhe rrugën e vetme ndërlidhëse. Ballin e kishte të lagur nga stërkalat e shiut tamburitës që i përplasej plot ngulm mbi fytyrë si pikëçuditëse të panumërta. Duart i dridheshin së bashku me bubullimat zullumqare që përshkonin hapësirën e dëgjimit duke ardhur prej së largu drejt e mbi veshët e tij mbi biçikletë. Anasjelltas, zhurmat shpërndaheshin prej timpaneve të shurdhët turravrapthi, drejt arave ku nuk shihje shpirt njeriu.

Një vetëtimë si një shpatë vringëllonjëse verbëtare u lëshua prej qiellit mu përpara tij. E kuptoi se ideja për tu rikthyer me aq ngut kishte qenë e gabuar dhe jo e matur mirë. Duhet të kishte dëgjuar fjalët e Sheqeres. Por nga ana tjetër në vetvete ushqente disiplinë ushtari. Ishte i vetëdijshëm për detyrën që i takonte. Se mos dinte të bënte diçka tjetër më mirë? Radhët e stërzgjatura të qumështit kishin edukuar brenda tij kokëfortësinë e goditjes së murit me kokë. Në ditë të mira dhe të këqija. Për më tepër në një ditë si kjo. Një krijesë e re po vinte në familjen e tyre. E për më tepër për shkak të atij provimi të matematikës që ia mbyste përlllogaritjen kohore të pasdites. Nxitohej. Në këtë kohë kur ky përrua i mallkuar kishte dalë prej shtrati dhe rruga, kanali, fusha, ishin bërë njësh, njëtrajtësuar

në një sipërfaqe ujore të përbaltur paanësisht ku nuk mund të dalloje dhe përcaktoje kufij ndarës.

Ndodhej gati-gati në mesin e udhës, kur duke mos dalluar ku ishte rruga dhe ku fillonte kanali, rrota e parë po e tradhtonte duke e drejtuar rrëshqitshëm drejt përroit. Ndjeu rrjedhën e fortë të ujit në gjoks. Paniku erdhi dhe depërtoi së bashku me mornicat në trupin e lagur. Por ajo që e habiste djaloishin ishte dora e pabindur instinktive që vazhdonte si e çmendur të mbante të shtrënguar timonin së bashku me bidonin e qumështit. Biçikleta po i ikte nga kontrolli dhe drejt rrjedhës shtyej më poshtë, më tej, më në humbëtitë. Dora e majtë, si një sfurk përmbledhës i kishte ngulur gishtat thellë mureve të kanalit drejt rrugës, ndërsa e djathta kokëforte nuk e lëshonte për asnjë çast atë çka mbante të shtrënguar për jetë-a-vdekje.

- Oh përrua i mallkuar! Ta dhjefsha shtratin! - Ishin të parat fjalë që i dolën nga shpirti në formë kuje.

Klithi:

- Ndihmë! Ndihmë!...

Ndjeu këmbët që i rrëshqisnin vend e pa vend duke mos krijuar bazamentin e nevojshëm për t'u ngritur. Po ndiente se e kishte davanë të humbur. Rryma po e gllabëronte në gjirin e vet. Por duart nuk pushonin së kryeri punën e tyre. Gjersa një sfurk ... Një sfurk u zgjat përpara syve të tmerruar të djalit. Nuk ishte dora e tij e majtë e shndërruar në sfurk. Por një sfurk i vërtetë. Plot shpresë klithi i gëzuar në ekstazë:

- Sindozot o Zot, o zot ...

Një sfurk përballë gjoksit të tij, dhe fjalët e tjetrit nga sipër, me çizmet e zhytura në ujë, mu në buzë të përroit, teksa i fliste nga lart duke ia ndërprerë fjalinë përgjysmë:

- Jëpi djalo! Kapu fort biro!

Zëri i tjetrit i zbritur si prej Kashtës së Kumtrit, ishte i magjishëm. I kapur me dorën e majtë pas sfurkut dhe zërit shpresë-dhënës, djaloishi ngrihesh më lartë. Dora e djathtë nuk e lëshonte për asnjë çast timonin.

- Lëshoje biçikletën more djalë. Lere drejtin të shkojë në esfel! - dëgjohej plot dert zëri i lodhur i fshatarit. Gulçonte me të gjitha forcat, me mish e me shpirt, për ta ringritur.

- Jo... Nuk... nuk e lëshoj xhaxho. Kam... kam qumështin aty...

- Lere more të hëngërt e mira qumështin dhe shpëto kokën! - gati-gati i ulëriu tjetri, duke turfulluar nën shi.

Por, ishte e kotë. Si të kishte qenë një pjesë e pandarë biçikleta, djali, dhe bidoni i qumështit të përllyer me baltë, dolën në sipërfaqe buzë rrugës.

I përndritur në të qeshura dhe mornica, djali e përqafoi plakun i cili e ndihmoi duke e hedhur mbi qerren e vet me të cilën dolën gjer në rrugën e asfaltuar. Duke u dridhur më tej pedalonte pareshtur në rrethinat e qytetit ku shiu kishte pushuar dhe një ajër i lagësht e kishte mbështjellë pasditen gjer në muret e banesës ku banonte. E lëshoi bidonin në dyshemenë e korridorit. Nga brenda dhomës zëri i të tjerëve e pushtoi sakaq:

- Po ç'u bëre, more djalë se na bëre merak! Nusja lindi çupë sot!

- U bëra me vajzë përsëri vëllaçko!

- Unë kam një kukull. Motra, ime e vogël...

-

- Ç'ka ngjarë?!

- Asgjë, ... - u tha me zë të qetë -

rrëshqita në një gropë kur po vija. Por, jam mirë. Mos u bëni merak.

Pa rënë në sy u drejtua drejt banjës. I futi thellë përfund koshit me rroba të palara veshjet e tij të lagura dhe të lerosura me baltë. I fshehu këpucët poshtë raftit. Pastroi sa mundi biçikletën dhe bidonin përpara se ta kuptonin se çfarë i kishte ngjarë atë ditë dhe filloi të shpëlante flokët, ballin, sytë.

Symbyllur t'u fanit fytyra e plakut mjekërbardhë ...

I sapo lindur, sikur në këtë kohë, ardhja tënde në këtë botë kishte përkuar *matematkeqësisht* me largimin e atit tënd, i cili e kishte humbur jetën në një aksident fatal. Që prej asaj kohe nga dhimbja nënës tënde i ishte prerë qumështi.

Emri i fshatit Dyshnik shpërbëhej numerikisht në *2shnik* duke prodhuar kështu matematkeqësisht toponimin e dyzimit tënd metafizik të farëzuar nën vorbullën e përroit Kushova, i cili mundet të kishte kush(t)uar jetën.

Kishte qenë e thënë ngjarja e kësaj dite apo ishte thjesht rastësi kjo nuk të interesonte aspak, përgjersa e KISHE SIGURUAR QUMËSHTIN E SHEQERTË NË SHTËPI. Sot ka ardhur një filiz i ri në familjen tuaj.

Të gjithë juve që i keni sytë e mbyllura në këto çaste, a ju kujtohet vështrimi i sybardhit që digjej atje në fshat nën temperaturë? Sapo t'i hapni syçkat tuaja që, rendin pas germave si fëmijët pas lojërave, jam i sigurt që do pohoni në heshtje duke tundur kokën ndërsa më pyesni:

- Po. E pastaj?

- E pastaj? Ç'ë e pastaj? Nuk di ç'të them. Fundi i fundit, që të jem i sigurtë, nuk kuptoj më tepër për t'ju dhënë shpjegime. Jam një djaloish ende i parritur. Një fëmijë që i ka munguar qumështi.

Shpesh më vjen keq për veten që jam duke e goditur me kokë murin e së panjohurës. Dhe «Murit nuk i bihet me kokë!». Por ku i dihet, ndoshta një ditë mundet të shfaqet ndonjë rreze e kuptimshme përtej tij. Dhe ju njëherësh keni për ta miratuar së bashku me mua idenë se ekziston gjithmonë jo pa vend shprehja «Ndoshta një ditë». Ndoshta. Ka për të qenë ndonjë e tillë ditë, e ngjashme edhe për ju, përgjatë udhëtimit që domosdoshmërisht kalon këndeje nga Rrugë e Qumështit.



MËNGJESI

Zbehet qielli n'agim dhe rete e purpurta,
Perparese te kuqe varen n'largesi-
Si n'anderr, dikur...Gurbetqaret ofshajne, tue dale
prej birucave n'periferine e larget e t'piklluemshme
dhe trupat e dermmueme ua lemon fresku i veses,
puhija e pare mengjesore...

Mengjesi per ta asht – anderr e shartueme
ne zhgjander t'zeze e t'mundimshme,
thirrje e pameshirshme per derdhjen e djerses
e t'gjakut –
qyteteve te largeta, rrugeve... per kafshaten e thate-
ai asht zgjim i idhet, plot andrrime per buke,
pse – cdo mengjes asht mundim i ri, perbuzje e perulje,
dita qe ka me sjelle tundime te reja, ma te randa,
shperthen ne mendje si agim' i purpurt
mbi nenkresen e shkyeme,
si thirrjet e largeta, t'kuqrrmenta...
Sepse – cdo mengjes asht një thirrje e dhimbshme:
– Buke per sot, o jete, pse shume buze presin prej meje!

...Dhe vetem nganjihere, n'mbrendi, botnat e reja
vetojne
hareshem: dit' ma t'lumtuna u bijne atehere ne t'pame
dhe rruget bardhoshe, si ame lumenjsh,
shkrihen, burojne n'vetedije dhe vizlojne para syve:
-Buke do te kete...dhe pune...-peshperisin
buzet e dridhshme.
-Voter te nxehte per te gjithë! – dhe shikimi
deperton ne'thellesi, zbulon botnat e meshehuna,
dhe dalin para syve –
fushat
qytetet
njerezit...

Zbulohet jeta e deshrueme!...

Mengjesi per ta asht anderr e kputun ne zhgjanderr
T'zeze e t'mundishme,
thirrje e pameshirshme per derdhjen e djerses
e t'gjakut
Qyteteve t'largeta, rrugeve...per kafshaten e thate-
ai asht zgjim i idhte, plot andrrime per buke.



MBRAMJA

Si tufa mëndafshi t'artë në të kaltërten shami,
n'mes dy duersh t'bardha, dy kodra në borë-
flakron përrëndimi...Retë mbi krye prorë
ngasin nëpër qiell dhe zhduken n'hapsi.

...Dhe drita e mbrame shuhet mbi çdo sukë:
cipa e natës shtrihet mbi fushat e përhimë,
malet heshtin n'errësi si me qenë të ngrime,
si të humbet jeta-xho gja u nxi, u zhduk.

N'ajri ndihen klithmat e natës që ra-
drujt pran rrugës era i përkund...
Ndërsa drita e bardh, e tretun dikund,

shigjeta të flakta mpreh errësinës me i ra.
Terri sundon botën. Katundet e shtrime
në mes të natës prehen n'lugin me andrrime.



poezi nga

ESAD MEKULI



MALLI PËR T'PAMBËRRIJTSHËMEN

Retë luejnë n'naltësin, si qingjat n'kodrina,
Ndërsa malli për t'pambërrijtshmen ndryhet n'mue:
Dëshirojsha mu kapë n'vallen e reve kuqle
E me fluture në t'shkëqyeshmet naltësina
Me gëzimin e këngës baritore...
E kur hana e luginave ia beh n'shpejti
Dhe toka natën n'dishrim thërret,
Si rrezet e argjendta mbi kalli-
Të shkoj
E t'vizitoj
Skajet e dhimbjes e vendet ku pashë ankthet.

Vaj! Me u kapë n'vallen e reve nkuqlime
Zemra me t'dhanun do t'më dëshironte
Që rinija t'gërthet i herë mâ me gëzime
Dhe mall i zemrës s'vuajtun t'gufonte.
-Por, pse zemra tingëllon përmallshëm
si za drithërim
dhe droja kaplon thellë zemrën e shpirtin tim?!
Kur dëshiroj aq rëtë mbi qytet me i soditë,
Derisa malli për t'pambërrijtshmen, m'kap, m'shafit.




ANDRRA E VAJZËS

Shushuritja e leht' e t'panjohtunit më treti fare
dhe agime t'kaltërta androva...

E nëpër kunor lakmish për 'limtare-
si lulja q'i jep qiellit lulzimin,
rinin ja dhurova.
Shkëlqyen yjet e qiellit si syt e tijë
të thellë dhe të ndritshm
dhe u shafit nën te e kërthnezta fuqi...

-Sonte shushurutja e leht'e t'panjohtunit
më treti fare
dhe agimet e kaltërta androva



NATA

Lugut t'qiellit fluturojne retë hijeranda
vedrat e territ tue derdhë mbi rrugët e plasarituna-
Nata e errët horizontet i mbylli...

Qiella tash bahet si cerep'i zi...
Dhe pikat e para t'shiut
hovshëm lëshohen mbi rrugë e pullaze.

...Diku, një za i piklluem, si ai i nanës mbi kufomën
e birit t'vetem;
thirrje e prekshme e dikujt, si ofshamë,
në shushurimën e errët t'shiut-
si klithje e femisë t'humbun në furtunë...

Bie me rreshek...Shiu end
pej t'panumërt...Bie pika si plumbi,
si kazmat e randa t'punterëve...
-O, si me dashtë me shembë çdo gja në këtë
natë t'merrshme!

Kujisin bagllamet e ndryshkuna në kapakët
e dritareve ku me hov sulmon shiu,
frushkullon erë e furishme... Lebetisin kunorat e
pemeve,
ulurojnë me za vajtues...
E drita e zbehtë dridhet në dhomezën e errët plot myk,
ku gurbetqarët t'rrasun fishek, ndër skuta ku nuk
pikon,
andrronjë shtretnit e ngroht, trupat e lodhun me i
çlodhë...

Era terbueshem uluron mbi pullazet e came t'shtepive,
dridhen trupat e ngrime nën leckat e mbulojes në
skutat e erreta t'dhomës,
në vorr për s'gjalli – të denuem për shfarosje...

Ferri i kësaj bote dorën ua shtrin t'mjerëve
para se me hy në parajsën e jetës s'amshueme!



GJYKIMI

Do të vijnë mbas nesh fëmijët tanë e fëmijët
e fëmijëve tanë
dhe ata do të flasin për ne, ata do të gjykojnë
për ne-
(Breznitë veprat i gjykojnë .. -ka thanë një njeri i
madh!)-
dhe nuk do t'na dënojnë, e di, për belbëzimet
tona, shtërzimet'
për gabimet-t'vogla e t'mëdha-për të
mbërrimet tona...
Pse-kush ka faj që prindet s'na lanë gadi kurrnga
-pos vorreve dhe padijes;
kush ka faj që aq kohë-errësia dhe vetmija-
si mrazet e pranverës kanë mbyt filizat mu në farë!
Do të vijnë mbas nesh fëmijët tanë e fëmijët e fëmijëve
tanë-breznitë,
dhe ata do të dijnë për ne, se ne jemi pjella e Ditës
së Re-dhe plot diell e dashni;
do të dijnë për ne, e di, dhe do t'ua kallxojnë me
binduni fëmive të vetë
si kemi ngallnjye, nga hini dhe vjetërsia,qytete t'reja,
fabrika dhe katunde...
si kemi shkruar këngë, si kemi thurë tregime-
tue belbzue ebecenë dhe gjuhën vetë...
(Dhe, ani, që të gjithë jemi marrë me çd! o gja, si me
qenë mjeshtër çollakë,
me pak dije po me shumë e shumë vullnet...)

MËSIMI I HARRESËS

tregime nga

SHKËLZEN HALIMI

NDARJA

Lutjet e mbrëmjes zakonisht përshkoheshin me të lehurat që vinin nga larg e që në muret e kasolles i përplaste furtuna e egër. Edhe ajo natë që bërë futë e zezë, kurse heshtjes sonë përmbajtje të zymtë i jepte flaka e qiriut, që lëkundej sa herë që lokja pshehtënte. Ishte natë e një dimri kërcënues. I shtrirë në një dyshek leckash dhe i mbuluar me shtresën e acarit, për herë të parë ndjeva pamundësinë e babait, ndjeva dhembjen e nënës dhe pikëllimin e lokes. Tentova të dal nga terri i imagjinatës dhe heshtjen e pllakosur ta shprishi me një buzëqeshje, por ndjeva se pamundësia e babait, dhembja e nënës dhe pikëllimi i lokes u bënë bashkë dhe përfunduan diku thellë në brendinë time. Më erdhi të qaj, por u përmbajta, duke u kthyer në krahun tjetër, në drejtim të murit. Kisha humbur edhe shpresën më të vogël për fundin e asaj nate që dukej si e shtangur. Lokja thyente gishtat, babai shikonte përtej dritares, kurse nëna dukej e humbur në kujtime. Të nesërmen herët në mëngjes, sapo më doli gjumi, nga dritarja e vogël pashë loken tek u përqaftua me babin, kurse nëna e përcolli deri në fund të oborrit. Asnjëherë nuk u kthye. Gjithë fëmijëria më kaloi në pritje.

Pastaj erdhën luftërat dhe në ikje e sipër ne u shpërndamë gjithandej. Lokja në një anën, nëna në anën tjetër, kurse unë përfundova diku në mes. E lamë shkrete fshatin. Kurrë më nuk i pash as ato, sepse mes nesh ishin ngritur kufij. Një ditë para se të futesha në odën e vetmisë, më ndali një plak mjekërgjatë dhe më tha: rojtari i varreve të fshatit tuaj më ka lutur që të shkosh atje, se varrin e babait tënd e ka mbuluar bari, kurse shkronjat e pllakës së mermertë pothuaj janë zhdukur.

Nuk shkova, sepse mendova se do ta tradhtoja fëmijërinë time që e kalova në pritje të babait. Nuk shkova, sepse mendova se do t'më vdiste edhe ajo pritje plot ankth, se përfundimisht do t'më zhdukeshin edhe ëndrrat e fëmijërisë tek qëndroja nën qershinë dhe sodisja rrugën që lëshohej luginës si një gjarpër i llastuar, prej nga ktheheshin mërgimtarët me pamje të ngrysur dhe me valixhe krahëve. Përtej dritares së pikturuar në murin e odës shoh veten fëmijë. Ai ende rri atje, nën qershinë e vjetër dhe është zhytur në mendime...

QERSHIA

Në oborrin e kasolles sonë kishim një qershi që lulëzonte në çdo të tretën pranverë. Lokja thoshte se vetëm qershia jonë e di kur vjen pranvera. Dhe kur lulet e saja përhapeshin nëpër degët e bollshme, atëherë lumna një njerëzish

kalonin pranë oborrit tonë për ta parë atë mrekulli që ndodhte një herë në tre vjet.

Një herë në tre vjet me lulet e saja të hedhura në ujë, ne laheshim në vaskën e drurit. Atëbotë lokja na zgjonte herët në mëngjes dhe na fuste në ujin që e ngrohte tërë natën. Pëshpëriste diçka që ne nuk e kuptonim. E di që ajo është lutur për shëndetin tonë, sepse kishte frikë nga sëmundjet e pashërueshme që të mbërthenin në shtrat për vite të tëra.

Një ditë mbi qiell u paraqitën re të zeza dhe fshikulloi një erë e fuqishme, të cilën qershia jonë nuk pati fuqi ta përballojë. Ajo u shkëlqy me gjithë rrënjë dhe u përplas në mes të oborrit. Në kasollen tonë pllakosi një heshtje varri. Nga habia dhe lemeria njëkohësisht, ndjeva se pikëllimi po ma ndrydhte fuqinë dhe rashë në shtrat për t'u ngritur pas shtatë ditëve. Shtatë ditë e shtatë net më kishte nënshtruar agonia. U zgjova në një mëngjes të zymtë, me sy të buhavitur, duke nxjerrë klithje të mbytura.

Dashurinë për qershinë e kam konservuar në arkën e kujtesës dhe është pema e vetme, frytin e të cilës nuk mund ta gëlltis. Në xhepin tim të fshehtë mbaj edhe një copë letre, ku e kam shkruar një vjershë (japoneze) që bën fjalë për qershinë. Një luftëtar që përgatitet të shkojë në betejë të reja, para se të largohet nga oborri i kasolles së vet, ndalet pranë qershisë dhe me një buzëqeshje mahnitëse, bën këtë lutje: "o qershi e dashur/ unë po shkoj./ Nëse nuk kthehem/ ti lulëzo".

I rrëmbyer nga dashuria për qershinë tonë të dikurshme, shikoj flakën e zbehtë mbi shandanin prej ari, shikoj ngjyrën e flakës që është e njëjtë me ngjyrën e luleve të qershisë, që në arkën time të kujtimeve vazhdon të lulëzojë në çdo të tretën pranverë, duke u larë me djersën e ftohtë që shpërthen në trupin tim nga sëmundja e pashërueshme, që më shtangu edhe në odën e vetmisë...



DRITARJA

Kur u zgjova i trembur, pashë se kishte kaluar mesi i natës. Shpejt e shpejt u ngrita nga shtrati dhe qëndrova pranë dritares së pikturuar në mur. Përtej xhamit vëreja një hije njeriu, duke nxituar drejt kopshtit të blertë. Të pashë tek freskoje fytyrën me ujin e kroit. Ishe fëmijë i njëjtë, ashtu siç të lash vite më parë, kur ika nga vendlindja. I njëjtë, me atë fytyrë të njomë që ndriçonte përreth, thuajse mbi të derdhej drita e hënës. Por, sakaq u zhduke, u trete, duke lënë në mua një humbellë të pafund. U mundova së paku t'i ruaj fragmentet e kujtesës që megjuloheshin, që mbuloheshin me ngjyrën e zezë. Sërish më mbërtheu një ankth, kurse frika nga çmenduria ma hapi shtegun për t'u dorëzuar përfundimisht. Pastaj tentova ta bindi veten se megjithatë ajo që vetëm një ëndërr si pasojë e lodhjes nga vetmia, nga etja dhe nostalgjia. U mundova të qëndroja duke qëndruar para pasqyrës. Nuk e dalloja dot fytyrën e ngrysur, nuk i dalloja sytë e lodhur nga pagjumësia. Nuk i ngjaja njeriut, por një qenie të frikshme, e cila zvarritej pa ndjenja. U përplasa mbi kashtën e vjetër, duke dënesur dhe duke e lutur Zotin që t'i japë fund kësaj katrahure. Aq më tepër kur ndjeva se kambanat e katedrales shënonin fillimin e një dite të re, e cila zgjonte përbindëshin e humnerave të kohës acar. Më ka lënë edhe shikimi dhe më nuk mund ta dalloj as kroin në kopshtin e blertë sa herë që qëndroj pranë dritares së pikturuar në mur. Ndoshta sërish je përvjedhur deri në kopshtin e blertë për t'u freskuar me ujin e kroit. Nuk kam dëgjuar asnjë lëvizje të më ketë ardhur nga jashtë pos rropamës së derës, të cilën unë e kuptoj si sinjal se është koha që shikimin ta drejtoj kah muri i harresës, pikërisht kah ai mur, mbi sipërfaqen e të cilit kisha pikturuar dritaren që s'hapej asnjëherë...

DËNIMI

Sa herë që qëndroj para pasqyrës shoh se nga ana tjetër më shikon me pamjen e përvajshëm. Ndonëse nuk ta dalloj fytyrën, sytë që të janë skuqur flasin vetvetiu se koha e mbrapsht nuk ka marrë fund. A po i dëgjon qentë e rojës që shqetësojnë kalimtarët e vonshëm, të cilët bashkë me pastruesit e rrugëve përgjojnë zërin e skëterrës. Lehin, pastaj heshtin, sërish lehin dhe sërish i vë në gjumë heshtja. Po më vjen një e vjellë, por s'kam ç'të nxjerr nga zorrët e tkurrur. Nuk duhet të mallkojmë, por ta dish se jemi të dënuar me vetmi të përgjeshme.

Në agimet e hershme të jetës sonë na ishte përcaktuar fati, kurse ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë nesër. A jemi ne ata që dikur, me ngjyrat e ylberit, vizatonim lule për mërgimtarët dhe shpresonim se do të na sjellin sheqerka. Kurrë s' e kishim vlarë mendjen se një ditë tinëz do t'ia vjedhim errësirën natës për t'u fshehur nga koha e mbrapshtë, e cila na i tradhtoi ëndrrat. U bëmë edhe hajna, por asnjëherë nuk u ankuam për faktin se kjo kohë na la vetëm frymëmarrjen dhe asgjë më tepër.

Kemi ikur duke zbritur tatëpjetës së fatit tonë, kemi zbritur deri aty ku përtej ka qenë ambisi i vdekjes. Po qëndrojmë buzë saj dhe mendojmë se si njëri të shpëtojë. S'mundemi, sepse jemi të lidhur si thoi me mishin. Ndaj bëmë paqe dhe herë - herë e shikojmë njëri tjetrin në pasqyrë, ti në anën tjetër me sy të skuqur e të përplotur, e unë në këtë anën duke i fshehur lotët. Kemi bërë paqe me veten dhe presim kasnecin të na sjellë lajme për shërimin e kohës vrastare...

ATJONI, NË 5 VITET E IKJES...

*Një mozaik me ngjyra dhe fjalë:
ç'tha dhe ç'bëri, ç'thanë dhe ç'bënë*

I. RRUGA E ATJONIT

Tani në Tiranë është edhe “Rruga e Atjonit”, andej nga kthehesh për nga Parku i Madh afër Filologjikut. Rrugë e vogël, mes pallateve të larta, që bashkohet me rrugën “Faik Konica” dhe pastaj fillon kalldrëmi përmes blerimeve të kodërzave përreth liqenit të Tiranës.

Në këtë rrugë është edhe shtëpia e Atjonit, dhoma e tij me librat dhe pikturat e tij, me kompjuterin dhe flautin, iPfone-in e aparate fotografike, me orenditë që kishte zgjedhur vetë e ç'kishte sjellë nga Italia, ku jetoi me vite, se prindërit e tij u emëruan dy herë në Ambasadën e Shqipërisë në Romë.

Kur ktheheshin në Tiranë, Atjoni te dhoma e tij edhe muret i vizatonte, shkruante nëpër to, edhe në derë. Si të thuash, ato ishin edhe ditari i tij.

Ja, nga këto shkallë zbriste, dilte në rrugën që do të merrte emrin e tij, për të takuar fëmijë të tjerë që të luannin bashkë në oborrin pranë shkollës së gjuhëve të huaja; pastaj, kur u rrit ca, për të marrë furgonin e me çantën e rëndë mbi shpinë të shkonte në shkollë; më vonë, ashtu i gjatë dhe i bukur, do të nxitonte në këmbë, me hapa të mëdhenj, me kufjet në vesh, për në gjimnaz.

Shpesh dilte edhe për në Qendër apo për në Bllok, të takonte shoqet dhe shokët, të kalonin mbrëmjet e vona apo të festonin ndonjë datëlindje, thjesht të bisedonin, ç'kishin lexuar a ç'film do të shikonin, teatër apo opera, ç'do të bënin kur të rriteshin, se ja, po mbaronte matura.

Shqipërinë do ta bëjmë më të mirë, thoshin vërtet. “Do të studiojmë nëpër botë e do të kthehemi që ta bëjmë ne vetë”, - ngulmonte Atjoni. Është e vërtetë, e dëshmojnë shokët dhe shoqet e tij.

Dhe Atjoni zgjodhi të studionte Filozofi, duke fituar një bursë në një nga Universitetet e njohura në Europë.

I ri mes të rinjve, si të gjithë ata që e donin dhe i donte, duke hapur një rrugë për në zemra.

Prandaj edhe Bashkia përuroi “Rrugën e Atjonit”.

II. “19-VJEÇARI I PËRHERSHËM”

Kështu e quan gjenerata e tij Atjon V. Zhitin, të riun emblematic të tyre, studentin ëndërrimtar që donte të bënte shumë, që dinte të jepte dashuri, vrull e optimizëm, që pëlqente artet dhe sportet e merrej me to, me gjuhët e huaja dhe shkencat politike, veprimtar europian, që “buzëqeshte çiltërsisht”, që ata që e njihnin, ia quajnë “kryevepër”, ndoshta buzëqeshjen e përftoi nga Nënë Tereza, kur e pa atë i vogël, ende në krahët e mamit në Romë dhe Shenjtja e preku me duart e rreshkura me përdëllim qiellor...

“Dy ishin dashuritë e Atjonit, - tregon një nga miqtë e tij nga Prishtina, -Atdheu dhe vajzat”. Prandaj dhe u bë ideali shpirtëror i gjeneratës së tij. E kërkonin, u gjendej pranë, u bëhej mbështetje me fjalën e sinqertë e të mençur, me ide e veprime. Nga larg dhe afër. Kur ishte dhe kur s'ishte.

- Lindi në qytetin e Vlorës më 30 gusht 1995 dhe u rrit me dashuri e përkujdesje, mes poezisë, ngjyrave dhe muzikës në Romë (Itali), ku prindërit punonin si diplomatë.

- Shkonte në kopsht. Kur ishte 3 vjeç e gjysmë, një vizatim i tij për “Nënë Terezën” iu botua në një përmbledhje në Itali për Shenjten dhe shkruan edhe gazetatat në Vatikan, “Osservatore Romano”, si dhe në Shqipëri.

- Hapi një “ekspozitë fëmimore” në shtëpinë e tij në Romë, e vizituan fëmijë dhe prindër të pallatit, jo vetëm ata të ambasadës.

- Më pas në Vlorë çeli një ekspozitë tjetër në kopshtin e shtëpisë së gjyshit, ku vizatimet e tij u varën pemëve. Dhe u mbledhën fëmijët e lagjes, duke pëlqyer, po aq sa pikturat, edhe ëmbëlsirat që u jepte mami i Atjonit.

- Mësimet e para i nisi në Tiranë, në shkollën katolike “Ylber”, ku merrej edhe me teatër.

- Arsimin 9-vjeçar e kreu në Romë në shkollën e muzikës “Giuseppe Sinopoli”, mësoi flautin dhe dha disa koncerte me orkestrën e shkollës, deri edhe në Auditoriumin e Romës.

- Nisi studimet në liceun e njohur klasik “Giulio Cesare” po në Romë ku, krahas italishtes dhe anglishtes, që i mësoi mjaft mirë, studioi dhe greqishten e vjetër dhe latinishten.

- Kishte pasion dhe muzeumet, i vizitoi të gjithë më të rëndësishmit në Romë e Vatikan, por edhe në qytete të tjera, Tiranë, Korçë, Vlorë, Krujë, Shkodër etj., por dhe në Firence, Venecia, Paris e deri në Çikago, SHBA.

- Merrej me sporte, me not, kanotazh, tenis etj., dhe shah.

- Përfundoi gjimnazin “Ismail Qemali” në Tiranë dhe bëri disa kurse kualifikimi për gjuhët spanjisht, frëngjisht e gjermanisht.

- Fitoi një bursë për të vazhduar studimet për Filozofi në Itali, ndërkohë ishte edhe anëtar i Parlamentit Europian Rinor, duke përfaqësuar Shqipërinë në disa Konferenca si në Spanjë, Letoni etj.

- Duke u pranuar si anëtar i ri i PEN Clubit Italian, krahas shkrimtarëve që kishte njohur në Shqipëri dhe Kosovë, donte shumë Pano Taçin dhe Ali Podrimjen, takohet edhe me poetë nga bota, Sebastiano Grasso, Mario Luzi, Adonis, Hermann Nitsch, Jevtushenko, nobelistin Derek Walcott etj., me Kadarenë patjetër, duke pasur dhe libra me autografe nga të tyret.

- Përkthen në shqip poezi të autorëve që ka njohur, si dhe për antologjinë “Lajmëtarët e Europës”, përgatitur nga i ati i tij; sjell poezi të panjohura nga Zai Fundo, per-

sonalitet i persekutuar politik; dhe do të jetë bashkëpërkthyes në librin e poetit të njohur në botë, Adonis, sirianit që jeton në Paris, që botohet për herë të parë në shqip në vitin 2014.

- Ndërkohë vazhdonte edhe pikturën si një adoleshent autodidakt, duke u përzgjedhur punët e tij për t'u vënë në ballina librash të ndryshëm, të botuar në Shqipëri, Kosovë e Itali.

- Në vitin e dytë universitar boton esetë e para filozofike të tij në gazeta në Shqipëri, në Kosovë dhe në median shqiptare në diasporë, Itali, Zvicër, Angli, SHBA.

Adhuronte edhe Faik Konicën. Kujtojmë që në një nga takimet e Parlamentit Europian Rinor në Barcelonë shkoi me qeleshe shqiptare në kokë, donte të ishte me kostum kombëtar “si Faiku, idhulli”, dhe ia dhuroi një danezi, ndërkaj me një shokun e tij nga Kosova dhe me atë serb aty, ngritën flamurin e Kosovës dhe të Serbisë pranë e pranë, për paqe dhe harmoni. Bëri atë që s'po e bën dot diplomacia dhe politika.

I pëlqenin aeroportet, avionët, që i dukej sikur e çonin jo vetëm qiejve, por edhe më pranë dëshirave dhe ëndrrave.

Mes studimeve dhe punëve të shumta, e fundit që zgjodhi të bënte, ishte organizimi i një sesioni parlamentar të të rinjve europianë dhe ku, në Korçë, *me shpresën që Europa të gjejë Europë te ne*.

Papritur, pas një aksidenti tragjik në Tiranë, në 20 dhjetor 2014, ndërpritën të gjitha...

- Në 2015 del libri i parë me ese, shkrime e statuse të mbledhura të Atjon V. Zhitit, “Për atë që dua(m)”, me jehonë në lexues dhe në media.

- Hapet ekspozita me pikturat e tij “Një kuti me xixëllonja” në universitetin “Polis”, Tiranë, nën kujdesin e kritikut të njohur të artit, profesor Gëzim Qëndro.

- Më 2017 botohet albumi “Opera Atjon”, në shqip dhe italisht, me vizatimet dhe pikturat e tij, të fëmijërisë dhe adoleshencës, përgatitur nga kritiku i artit dhe botuesi Gëzim Tafa, me pasthënie të tij dhe parathënie nga Gëzim Qëndro. Albumi ka pasur jehonë brenda dhe jashtë vendit.

- Revista “Poeteka” një numër të sajën e ilustron me vizatimet bardhezi të Atjonit.

- Koncert për Atjonin në Romë, *Jehonë dhe butësi - dialog mes tingujve dhe një engjëlli*, drejtuar nga violinistja e njohur Anyla Kraja, ku një aktor recitoi nga shkrime të Atjonit. Veprimtaria u zhvillua në Kishën Franceze në Piazza Navona, aty që, kur ishte fëmijë, Atjoni rrinte me orë të tëra për të parë statujat, shatërvanët dhe klounët.

- Më 2018, pas librit me tregime “Valixhja e shqyer”, dalin edhe dy përmbledhje me poezi, “Dove é la vita” në Itali dhe “Të rritesh nga dashuria” në Shqipëri, që të tria me ilustrime të Atjonit si bashkautor me Visar Zhitin, teksa libri i tretë ka edhe një parathënie nga mami i Atjonit, Eda Zhiti.

- Me piktura të Atjonit dhe me citate të tijat në tri gjuhë, shqip, italisht dhe anglisht, kanë dalë kalendarë vjetorë.

- Fotografia e Atjonit është edhe mes fotove të shkrimtarëve të tjerë në librarinë “Friend's Book House” në Tiranë, afër vendit ku ai studionte.


- Piktore të njohur, si Ibrahim Kodra, Maks Velo, Nestor Jonuzi, Skënder Kamberi, Denis Kapo etj., kanë bërë portrete të Atjonit fëmijë, po kështu edhe autorë të huaj kanë realizuar ikona dhe qeramikë me portretin e Atjonit, kurse piktori Gjergj Kola ka ekspozuar dhe në Luver dhe ka një cikël punësh dhe në vaj me personazh Atjonin.


- Përzgjedhje nga esetë e Atjonit janë përkthyer edhe në italisht, ndërsa në rumanisht janë të botuar në revistën “Albanica”.

- Në tekstet e letërsisë për shkollat 9-vjeçare, botimet “Albas”, është edhe një poezi e Atjonit me foton e tij.

- Botimet e Atjonit janë në bibliotekat e shkollave ku ai ishte nxënës dhe në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, në bibliotekën e universitetit “Sacro Cuore” në Milano etj., deri dhe në Uashington, në Bibliotekën e Kongresit Amerikan.

- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “Giffoni” jep çdo vit çmimin “Atjon Zhiti” për anëtarin më të mirë të jurisë, ku





Atjoni bënte pjesë dhe u shqua.

- IWA BOGDANI, Shoqata Ndërkombëtare e Shkrimtarëve me qendrat në Bruksel/ Belgjikë dhe Prishtinë/ Kosovë, themelon Çmimin Ndërkombëtar vjetor për poezi “Atjon V. Zhiti”, çmim ky që ka shkuar në kontinentin amerikan dhe atë aziatik.

III. DHE ATJONI THA:

12 citate, të nxjerra nga libri për “Atë që dua(m)”, botuar në Kalendarin e Vitit 2019 në shqip, italisht dhe anglisht nga “Onufri”

1- Të bësh të kthehen gjërat në shërbim të lumturisë së njeriut.

2- Drejtësia është ai princip ku çdokush bën vetëm ato gjëra që prej natyre e ligji është thirrur të bëjë.

3- Shkencat shkojnë para, sepse nuk gabojnë dy herë në të njëjtën mënyrë, po ashtu si dhe njerëzimi. Në shoqërinë tonë është dramatike se si të qenët zëvendësohet nga dukja.

4- Duhet pasur si burim force e, njëkohësisht, “them-bër Akili” vlerat e paqes e të kulturës.

5- Kërkimi është zhveshje.

6- Të ndërgjegjësohemi e së bashku të bëjmë një kryengritje morale të vazhdimtë.

7- Dashuria ime është te ju, sepse ju dua shumë, jam i menduar, se dua të jem te ju: zemër.

8- Dashuria për dije është e pakohë dhe e tillë do të jetë. Nuk do pranoj çka nuk më pëlqen, por do të mundohem të njoh gjithçka, kohë nuk kam për paragjykimë, tabu, etj.

9- Tirania luftohet me dije, gatishmëri ndaj vuajtjes, intelektualizëm dhe objektivizëm ndaj realitetit pa pasur frikë.

10- Kur padrejtësia e përgjithshme bëhet rrugë, rezistenca është detyrë.

11- Që konflikti të mos jetë torturë, por vuajtje intelektuale, mundësisht gëzim. Lumturia është detyrë, por të mos ndihet si e tillë.

12- Jeta s’duhet mbivlerësuar duke menduar se është e gjatë dhe e përjetshme, por njëkohësisht nuk duhet nënvlerësuar duke thënë se është e kotë dhe e shkurtër, jeta është një hua dhe ne duhet ta lajmë atë duke bërë mirë.

IV. DHE THANË PËR ATJONIN:

1- Kjo fytyrë e bukur engjëlllore... ajo krijesë e mrekullueshme pra, ishte bërë për qiellin, jo për këtë botë...

Helena dhe Ismail Kadare, shkrimtarë

2- Atjoni është djali që çdo prind do të donte ta kishte të tijin...

Sebastiano Grasso, poet, president i PEN Clubit, Itali

3- Nuk kam takuar një të ri kaq të mirë, kaq fisnik

dhe kaq të dashur në Shqipëri sa Atjoni...

Robert Elsie, albanolog kanadez

4- Kur do ta takoja për herë të parë Atjonin... shkëlqente nga poezia. Dhe vetë ai është një poezi e magjishme.

Adonis, poet sirian, jeton në Paris, Francë

5- Libri i Atjonit – testament i Tij... si Ungjilli për bashkëmoshatarët e tij, *fari ndriçues i brezit të tij...*

Eugjen Merlika, studiues, kritik letrar

6- Atjoni jetoi me optimizëm dhe i përkushtuar për artin dhe jetën... Mbetet një shenjë që simbolizon shpresën dhe gjallërinë rinore.

Akademik, Prof. Dr. Jeton Kelmendi, president i International Writers Assosiation ‘Pjetër Bogdani’

7- ...e di se sa të rrallë janë në këtë vend të rinjtë që mbajnë në çantë Heidegerin dhe Guy Debord-in dhe që kanë kaq shumë potencial intelektual dhe fuqi shpirtërore brenda vetes. Si të gjithë pinjollët e racës së krijuesve, Atjoni nuk doli kurrë nga kopshti i magjepsur i fantazisë së tij. Si fëmijë i çuditë të rriturit me sigurinë dhe fjalët e pjekura, si i rritur i habiti me spontanitetin dhe pastërtinë e fëmijës...

Gëzim Qëndro, kritik arti, piktor, profesor universiteti

8- Kapja e Universit në të gjitha dimensionet. Kjo është fabula e pikturës së tij. I mbërthyer nga ky detaj artistik... ajo tingëllon përtej moshës dhe me tendencë të dukshme ndaj artit modern, abstraksionit apo minimalizmit... Për të fluturuar drejt së pamundurës, përjetësisë...

Gëzim Tafa, kritik arti, piktor, botues

9- Atjoni qoftë i bekuar te Zoti dhe sjelltë bekime pa fund...!

Skënder Buçpapaj, poet, gazetar, Zvicër

10- Bota është më e varfër pa Atjonin, ne jemi më të varfër pa të, është një bosh i madh... një trishtim i madh... Një engjëll i bukur që na fali gjithmonë dashuri, ngrohtësi e miqësi... Shikonim shumë prej projekteve tona të parealizuar tek ai...

Luan Topçiu, kritik arti, studiues, përkthyes Bukuresht, Rumani

11- Është tronditëse, një mrekulli në ngjyra. Gjej vizatime të Atjonit që janë ashtu si në kaligrafinë antike kineze, në atë të parën fare. Një fëmijë që mbledh kështu shpirtin e figuracionit të një civilizimi 4000-vjeçar dhe arrin të njëjtën sintezë, e bën njeriun si atëherë, një sensibilitet ky, ku dëgjohej bota. Do t’i jap në kurset e leksioneve në Universitetin Gregoriano në Romë për studentët.



Atjoni ka ndier shpirtin universal, shpirtin e Zotit, me rëndësi humane.

Padre Marko Rupnik,

profesor në Universitetin Gregorian në Romë. Teolog, artist, mozaicist me vepra të famshme në të gjithë botën.

12- ...ishte i veçantë; kushdo që e ka njohur, edhe për një ditë o për një orë, nuk do të mundte ta harronte... tepër inteligjent, i mirë e i ëmbël... i mrekullueshëm e i dashur nga të gjithë... Do ta kujtoj përgjithmonë.

Një e panjohur

V. POETË FITUES TË ÇMITIT NDËRKOMBËTAR “ATJON ZHITI”

Me motivacionin *Për pasionin dhe singeritetin në art dhe krijimtari*. Në vitin 2018 iu dha poetes hebreje nga Argjentina, Susana Robert, dhe për vitin që jemi, 2019, sapo iu dha poetes japoneze Kae Morii, të njohura dhe të përkthyer edhe në gjuhë të tjera.

Ato jo vetëm që e mirëpritën edhe këtë çmim, por duke kërkuar të njohin më shumë dhe më mirë Atjonin, janë frymëzuar për të shkruar poezi të tjera...

Kae Morii PUTHJET

Unë puth zogjtë në një skicë
Unë puth konturet e pemëve që t’i kthjelloj
Unë puth një rruazë vesë mbi lulediellin.

Unë puth një ballë xhami vullkanik
Unë puth një buzë druri hibiskus
Unë puth një gji madhështie të truallit.

Unë puth arsyen duke u ngritur lart
Unë puth elegjinë e zhytur në zemrën tënde
Thellësia jote
Sekreti i lindjes
Unë të puth ty.

Susana Roberts PËR ATJON ZHITIN

Poemë kushtuar Atjon Zhitit (i riu shqiptar, gjeni në letra dhe filozofi, që pësoi një tragjedi, teksa emri i tij nderohet në disa vende dhe mua m’u dha Çmimi i Laureatit). Ndërkaq desha t’i jap jehonë kësaj poeme, se ai më frymëzoi, edhe pse me vonesë, po kështu dua t’i gjendem pranë familjes së tij dhe më është bërë me dije se poezi të miat janë botuar në disa gazeta, në Zvicër, Nju-Jork, Belgjikë, Shqipëri... Mirënjohjen time të plotë në këtë lidhje të shpirttrave pa kufij.

Sot, kur dielli më thoshte mirupafshim
Një zog i vogël u përshfaq nëpër degë
dhe trëndafila të rinj lulëzuan befas.

Ngulmuese desha të dëgjoj këngën e zogut,
Ndenji gjatë, një gjysmë ore a më shumë
M’u bë se ti, Atjon, ishte mes petaleve të melodive
Vallëzues me format e natyrës.

Shpirti yt po më thoshte të mbroja rrjetin
Që lidh njerëzit, ku njerëzit flasin për të tjerë njerëz
se njerëzit i dëshpëron fati i tyre,
se njerëzit nuk ushtrojnë bashkimin
Pastaj... ti flatrove me zogun, por para kësaj,
ma qarkove gjithë qenien time
Me mrekullinë e buzëqeshjes tënde
që s’e kisha parë në jetë.
Dhe e kuptova që njerëzit kurrë nuk vdesin,
sot që më vizituar nga një horizont i largët
e bekova identitetin tënd sublim
me rrezen e mbramë diellore që më ra mbi fytyrë.

*Përgatiti dhe përktheu nga anglishtja dhe italishtja
Dardan Shkreli*

Në faqen e parë: Pllakati i koncertit për Atjonin në Romë
“Atjoni me kostun kombëtar” nga Gjergj Kola, në një ekspozitë pranë Luvrit, Paris

SALVADOR DALÍ

A mos jam gjení vallë?

Në moshën gjashtë vjeç doja të bëhesha kuzhinier. Në moshën shtatë vjeç, Napoleon. Edhe më vonë dëshirat e mia shtoheshin jo më pak sesa synimi për t'u ngjitur sa më lart drejt madhësisë.

Në ditarin e Stendalit përmenden fjalët e njëfarë markeze italiane, e cila, në një mbrëmje vere me vapë përvëluese, kishte provuar akulloren: "Sa keq që kjo nuk është një kënaqësi mëkatore!". Kështu pra, kur unë isha gjashtë vjeç, ishte mëkat i madh të haje bukë në kuzhinë. E kisha të ndaluar nga prindërit të hyja në atë pjesë të shtëpisë. Mbaj mend që, duke kapërdirë jargët, gjeja rastin të depërtoja në *sancta sanctorum* (vendin e shenjtë), domethënë në vendin e kënaqësive të papërfytyrueshme. Megjithatë, ndonjëherë arrija të hyja atje, i ndjekur nga britmat e shërbyeseve... Dhe, ndonëse më kërcënonte ndonjë shuplakë e mirë, me shpirt ndër dhëmbë, rrëmbeja ose ndonjë copë mishi, ose ndonjë kërpudhë të skuqur dhe, në kulmin e ngazëllimit, dilja me vrap, gjë që e rëndonte edhe më tepër fajin.

Çdo gjë tjetër më lejohej. Ndërsa të hyja në kuzhinë, në asnjë mënyrë. Deri në moshën tetë vjeç shkruaja duke ndenjur shtrirë në shtrat, vetëm e vetëm sepse ashtu më pëlqente. Në shtëpi isha unë që mbretëroja e jepja urdhra. Për mua nuk kishte asgjë të pamundur. Babai dhe nëna vetëm që nuk faleshin përpara meje. Ditën e *Infantës*, midis dhuratave të shumta, mora edhe një kostum të mrekullueshëm mbretëror, një pelerinë të qëndisur me lëkurë të vërtetë kunadheje dhe një kurorë prej ari me gurë të çmuar. E kam ruajtur për një kohë


shumë të gjatë atë vërtetim të shkëlqyer (ndonëse si në maskradë) të të qenit i zgjedhuri i familjes. Mbaj mend se shërbëtoret ruanin syçelë që gjëja e ndaluar për mua të mos shkelej në asnjë mënyrë, kështu që, sa më pikasin, më zbonin... Dhe ja, unë po rrija si i ngurosur në gjysmerrësirën e korridorit, i veshur me rrobat mbretërore, në njërën dorë mbaja skeptrin, ndërsa në tjetrën, që më dridhej vazhdimisht, një kamxhik: isha gati t'i fshikulloja ato kafshë në mënyrë që ta merrnin vesh se me mua nuk mund të talleshin! Skena të tilla luheshin zakonisht afër mesditës, në atë orë sflitëse të verës, kur në ajrin që nuk të mjafton për të mbushur mushkëritë, fillojnë e lindin vegime. Fshihem pas derës gjysmë të hapur të kuzhinës dhe dëgjoj se si vrapojnë, me sa kanë fuqi prapa meje, ato gra-kafshë me duar të kuqërremta, shoh trupat e tyre të fuqishëm dhe jelet e shpupuritura. Në vapën e mesditës, midis zhurmës së shurdhët të përgatitjeve të drekës, arrin deri tek unë duhma e thartë e djersës së grave, e kokrrave të rrushit, e vajit të nxehtë, e qimeve të hequra nga lëkura e lepujve të butë, e veshkave dhe e majonezës, që e mbulojnë aromën e gjellëve, dhe të gjitha këto bashkohen e bëhen njësh duke më krijuar ndjesinë e erës së kalit. E bardha e rrahur e vezës, që shkëlqen si rreze dielli, shpërthen nëpërmjet shtëllungave të tymit dhe resë së mizave duke ndriçuar pikërisht si shkuma që u del kuajve, të cilët, pas një vrapimi të gjatë nëpër rrugën e pluhurosur, fshikullohen deri në përgjakje. Siç edhe e thashë, unë kam qenë fëmijë i llastuar e i mbrapshtë...

Vëllai im vdiq tre vjet përpara se të lindja unë,

në moshën shtatëvjeçare, nga meningji. Babai dhe mamaja ime e ngushëlluan dëshpërimin e tyre me ardhjen time në jetë. Unë me tim vëlla ngjanim si dy pika uji: po ato fillesa gjenialiteti (më vonë, në vitin 1929, mua m'u shfaq vetëdija e prerë e gjenialitetit dhe, ndonëse u përforcua shumë brenda meje, nuk më shkaktoi asnjë shenjë nga ajo që quhet mani e madhësisë) dhe po ajo shprehje e shqetësimeve të kota. Ne dallonim vetëm në disa tipare psikologjike. Jo vetëm kaq, por edhe vështrimin ai e kishte pasur të ndryshëm, si të mbështjellë nga melankolia, nga një meditim "i pakapërcyeshëm". Unë nuk isha dhe aq i mençur dhe, si për ta plotësuar këtë, më ishte dhënë aftësia të reflektoja për gjithçka. U bëra reflektues i shkallës më të lartë për shkak të "polimorfizmit tim të shtrembëruar", si dhe i prapambetjes fenomenale në zhvillim. Meqenëse më ishin ngulitur në tru disa kujtime të turbullta nga parajsa me prejardhje erotike të fëmijës së gjirit, me një kryeneçësi prej egoisti, kapesha fort pas kënaqësive. Në këtë fushë nuk hasja në kundërshtime, prandaj edhe bëhesha i rrezikshëm. Një mbrëmje, sesi i gërvishta me gjilpërë faqen tajës sime, vetëm e vetëm sepse shitorja ku ajo më çonte për të blerë ëmbëlsirat e mia të dashura ishte e mbyllur. Kështu pra, nuk kishte dyshim që unë isha një fëmijë plot gjallëri. Vëllai im ishte vetëm prova e parë e vetes sime, që ishte ngjizur tek unë me tepriçë absolute.

Tani ne e kemi të qartë që forma është rezultat i dhunës prej inkuizitori mbi materien. Hapësira e shtyp atë nga të gjitha anët, kështu që materies i duhet të mbrohet dhe të tendoset, të arrijë deri në kufijtë e mundësive të saj. Kushedi sa herë, materia e frymëzuar nga vrulli i tepriçës absolute, vdes, zhduket? Edhe materia më e aftë për t'u përshtatur, që është shumë më e thjeshtë në kërkesat e saj, i kundërvihet tiranisë së hapësirës, duke u rrekur t'i përmbahet thelbit të formës së saj origjinale. A ka gjë më të lehtë, më të lirë dhe më me fantazi se ngjyrimet e kristaleve minerale? Por edhe ato janë prodhim i "mjedisit koloidal" të përqendruar, i cili, duke i munduar, i mbërthen dhe i përmbledh në një strukturë të ngurtë. Degëzimet më të përkryera dhe më ajrore janë vetëm e vetëm një grafik i agonisë, i vuajtjeve të dëshpëruara, i frymëmarrjeve të fundit të materies, e cila vdes, por nuk dorëzohet, është ngjyrimi i fundit i botës së mineraleve. Por edhe për trëndafilin, ligji është po ai! Çdo lule bulëzon nën trysni. Liria është pa formë. Morfologjia (lavdi Gëtes që e ka shpikur këtë fjalë i ngazëllyer nga pafundësia krijuese e Leonardos), pra morfologjia na zbulon se, krahas mbretërisë fitimtare të hierarkisë së ngurtë të formave, ka edhe prirje më





anarkike dhe më të ndryshme në lloje, të cilat gërryen nga kundërshtitë.

Në këtë mënyrë mendjet e ngushta e të kufizuara u dogjën nga zjarret e Inkuizionit të Shenjtë, shpirtat heterogjenë dhe anarkikë mbartën mbi vete pasqyrimin e zjarrit të madhërishtëm të morfologjisë së tyre shpirtërore. Siç e përmenda, vëllai im kishte pasur aftësi meditimi të një vetie të veçantë, të papërbalueshme, e paafte të ndryshonte pamje dhe që ndrydhte vetveten. Ndërsa unë, si e kundërta e tij, isha një shthurje polimorfe, e gjallë dhe anarkike. Të gjitha veprimet e mia të vetëdijshme shpreheshin në makutërinë time, dhe e gjithë makutëria bëhej një veprim i vetëdijshëm. Gjithçka ma ndryshonte pamjen dhe asgjë nuk ma ndryshoi thelbin. Unë kam qenë i plogët, frikacak dhe kundërthënës. Në ashpërsinë e mendimit spanjoll, natyra ime kërkonte shfaqjen më të madhërishtë të kristaleve të gjalla, të përsosura dhe trillane të gjenialitetit tim të papërsëritshëm. Prindërit më pagëzuan Salvador, ashtu si tim vëlla. Dhe, nga kuptimi i emrit, mua më ishte paracaktuar, as më shumë e as më pak, por të shpëtoja Pikturën nga paqenësitë e modernizmit dhe kjo do të ndodhte në epokën e katastrofave, në atë gjithësi mekanike e të zakonshme, në të cilën ne, për fat të mirë dhe për fat të keq, jetojmë. Sikur të kisha mundësi të gjendesha në të Kaluarën, Rafaeli dhe të ngjashmit me të do të më dukeshin perëndi të vërteta. Ka të ngjarë që unë të jem i vetmi

njeri që e kam kuptuar se pse sot është e pamundur t'u afrohem formave rafaeliane. Krijimtaria ime, mua vetë më duket një fatkeqësi e madhe. Si mund të jetoja unë në epokën time, kur nuk do të kisha mundësi të shpëtoja dot asgjë! Por duke u kthyer tek e Tanishmja e quaj ogur të mirë që shumë mjeshtra i kam vlerësuar më tepër se veten, por, megjithatë, nuk do të doja të ndërroja vendin me asnjërin nga ata që sot janë gjallë.

Ta arrish dhe ta shprehësh kuptimin e jetës i vetmuar do të thotë të krahasohesh me titanët e mëdhenj të Rilindjes. E tillë është gruaja ime Gala (Elena Dmitrievna Djakonova, me prejardhje ruse), e cila qe lumturi për mua. Lëvizjet e saj fluturake, gjestet dhe aftësia për t'u shprehur, i ngjajnë Simfonisë së Dytë: shfaq tiparet arkitektonike të shpirtit të përkryer, që kristalizohet në begatinë e vetë trupit, në aromën e lëkurës, në shkumën detare të shndritshme të jetës së saj. Duke shprehur frymëmarrjen e stërholluar të frymëmarrjes së ndjenjave, plastika dhe aftësia e të shprehurit materializohen në arkitekturën e patëmetë prej mishi e gjaku.

Kur Gala pushon, mund të them se i ngjan kishëzës *Tempietto di Bramanti*, që ndodhet në afërsi të *Shën Pjetrit Montozio*, në Romë. Dhe ashtu si Stendali në Vatikan, unë më vonë, dhe pavarësisht prej tij, mund të vë në një rrafsh krenarinë e saj, kolonat e bukura, parmakët e butë e të qëndrueshëm, me pamjen fëmijërore të saj, shkallët hyjnore me buzëqeshjen e

saj. Orë të tëra përpara këmbalecit të piktorit, duke e admiruar vjedhurazi, në kohën kur ajo nuk e vinte re këtë, unë i thosha vetes se ajo është një tablo po aq e bukur sa punimet e Vermejerit dhe të Rafaelit. Në një kohë që të tjerët, ata që na rrethojnë, na duken të vizatuar aq dobët, të skalitur aq dobët, saqë ngjajnë më tepër me karikatura të pështira, të laparosura në ngut e sipër nga ndonjë piktor i uritur në tarracën e ndonjë kafeneje.

Në moshën shtatëvjeçare unë doja të bëhesha si Napoleoni... Ja se si ndodhi. Në katin e dytë të shtëpisë sonë banonin argjentinasit Mammás. Njëra nga vajzat e asaj familjeje, me një bukuri përrallore, Ursula Mammás, sipas zërave që u dëgjuan, u bë katalanasja e vitit 1900. Flitej gjithashtu se Eugenio d'Ors, në librin e vet "La Ben Plantada" ("Shtathedhura"), pamjen e kata-lanasës e kishte pikturuar duke u nisur nga fytyra e saj. Në vitin tim të shtatë më kaploi joshja seksualo-aristokratike ndaj katit të dytë. Gjatë buzëmbremjeve të ngrohta, unë rrija për orë të tëra në tarracë, derisa fëshfërima sipër, që me zor ndihej, më tregonte se mbi mua po hapej dera e ballkonit. Në katin e dytë më donin aq sa edhe në shtëpinë time. Rreth orës gjashtë të mbrëmjes, përreth tavolinës monumentale në sallon, mbi të cilën qëndronte varur një i balsamosur lejk, mblidheshin për të pirë *mate* disa zonja të mahnitshme, me flokët të fryrë dhe që flisnin me theks argjentinas. *Mate-në* e shërbenin në një enë të madhe argjendi, e cila kalonte nga njëra buzë te tjetra. Ajo afërsi e ngushtë buzësh më emociononte dhe më lindte në shpirt një qerthull i tërë pasionesh, në të cilin fillonin të shndrisnin majat e mprehta të xhelozisë.

Kur më vinte radha, edhe unë e gjerbja lëngun e ëmbël, që për shijen time ishte më i ëmbël se mjalti, ndërsa mjalti, më i ëmbël se gjaku. Sepse ime më, gjaku im, ishte gjithmonë po aty. Në këtë mënyrë, fillesa ime aristokratike ishte një marshim triumfal nga buzët në buzë, nga goja në gojë, kështu që unë doja të pija kupën e Napoleonit, pasi Perandori ndodhej gjithashtu në sallonin e katit të dytë, ndonëse jo personalisht, gjithsesi, aty ndodhej përfytyrimi i tij në faqen e një fuçie të vogël druri, në të cilën ruhej *mate-ja*. Ai Napoleon me rëndësi olimpike, me barkun e bardhë e të ngopur, me faqet e tij perandorake të trëndafilta, me kapelë të zezë, i përgjigjej pikë për pikë përfytyrimit tim të asaj se çfarë monarku mund të isha unë vetë.

Në atë kohë ishte në modë kënga:

Napoleon en el final
De un ramillet colossal.

Paraqitja e Napoleonit në faqen e fuçisë e kishte përpirë përfytyrimin tim, po aq të egër sa edhe e bardha e vezës në pjatë (apo ndoshta pa pjatë). Dhe i ndikuar nga Napoleoni i pijshëm, nëpërmjet *mate-së* ndodhi një kërcim i fortë i joshjeve të mia, nga kuzhinieri deri tek perandori. Pikërisht në këtë mënyrë, ndjesitë e mia erotike të grave-kuaj, që ecnin me galop nëpër kuzhinën tonë, u nxorën jashtë fushës sime të pamjes nga përfytyrimi i shndritshëm i Ursula Mammásit, i bukuroshes të llojit të vitit 1900. Më vonë do t'i përshkruaj me hollësitë e "makines që mendon" zbulimet e mia. Njëra prej tyre, të paktën, është e bazuar në idenë e Napoleonit të pijshëm, në të cilin u mishëruan dy fantazmat e fëmijërisë sime të hershme. Jermi i buzëve (gojëve) dhe imperializmi i verbër shpirtëror. Kjo e shpjegon se pse pesëdhjetë kupa me qumësht të ngrohtë, të vendosura mbi një karrige të lëkundshme, ishin për mua njëlloj si kofshët buçkane të Napoleonit. Për ta përfytyruar një gjë të tillë, nuk duhet të jesh i çmendur! Kjo shprehej edhe në sende të tjera, që, të para në dritën e këtij libri, nuk janë më pak të çuditshme dhe më të pakundërshtueshme. Gjithsesi është e vërtetë: gjithçka, absolutisht gjithçka që them këtu, është tërësisht mëkati im, mëkati im i vetëm.

Përktheu Guri Shyti



MINISTERO
PER I BENI E
LE ATTIVITÀ
CULTURALI

“La figura di Skanderbeg in Europa e in Arbëria. Storia, luoghi e percorsi nel Meridione arbëresh”



20 dicembre 2019 • Ore 18:00
PIO OSPIZIO “G. De Benedictis” - LUNGRO (CS)

Saluti:

Giuseppino Santoianni Sindaco di Lungro
Rosa Carbone Presidente Pro Loco Arbëria

Interventi:

Antonio Martino Consigliere comunale, delegato Cultura e Pubblica Istruzione
Francesco Altimari Fondazione universitaria "F. Solano" - Unical
Matteo Mandalà Università di Palermo - Cattedra di Albanologia
Nando Pace Studio Tearkè

Coordina:

Nicola Bavasso Giornalista